

Bankers Petroleum Albania Ltd

Dega në Shqipëri

Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

Njohja e entitetit

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri (“Dega”) është krijuar si degë e Bankers Petroleum Albania Ltd. (“Shoqëria mëmë”), një shoqëri e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve të Ishujve Cayman. Dega është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Shqipëri më 28 korrik 2004 dhe është e angazhuar në kërkimin, prodhimin dhe shitjen e naftës bruto.

Mëma është plotësisht në pronësi të Bankers Petroleum International Limited, një shoqëri e themeluar në Jersey dhe e zotëruar 100% nga Bankers Petroleum Ltd. (“Shoqëria mëmë e ndërmjetme”), një shoqëri e themeluar në Kanada. Shoqëria mëmë perfundimtare është Charter Power Investment Limited, një shoqëri e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve të Hong Kongut.

Dega operon në fushën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës në pajtim me Marrëveshjen Hidrokarbure dhe ndryshimet e mëvonshme, të nënshkruara midis mëmës dhe Albpetrol Sha (Albpetrol), shoqëri e naftës nën pronësi shtetërore, nën licencën ekzistuese të Albpetrolit me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Marrëveshja e Patos-Marinzës u bë efektive në mars 2004 dhe ka një afat 25 vjeçar me opsionin për t’u zgjatur dhe për pesë vite të tjera, me zgjedhjen e shoqërisë mëmë, pas miratimit të qeverisë dhe organeve rregullatore.

Modeli i biznesit

Dega operon në fushën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës dhe është e angazhuar në kërkim, prodhim dhe shitjen e naftës bruto. Vlerat thelbësore të Degës janë edhe themelet drejt suksesit. Bankers udhëhiqet nga integriteti, inovacioni, përgjegjësia shoqërore dhe investimi. Ne punojmë fort për të fituar besimin dhe konsideratën e partnerëve tanë.

Në Bankers, ne përpiqemi maksimalisht për tu pozicionuar si një partner i zgjedhur për Shqipërinë për të operuar në vendburimin më të madh të vendit. Bankers ka bërë të mundur, në saj të ekspertizës, të prodhojë sot më shumë se në 85 vjet histori të vendburimit. Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit Bankers është rritur për të qenë investitori, tatimpaguesi dhe punëdhënësi më i madh në Shqipëri. Bankers do të vazhdojë të bëjë investime të rëndësishme në zonën naftëmbajtëse në vitet që do të vijnë dhe ka objektiva të larta lidhur me rritjen e rezervave, prodhimin dhe shitjet.

Integriteti dhe përgjegjësia personale me një perkushtim të palekundur ndaj sigurisë dhe mjedisit janë të pranishme te çdo punonjes. Ne respektojmë dinjitetin, të drejtat dhe diversitetin kulturor të industrisë sonë globale. Bankers promovon inovacionin që përmireson veprimtarinë dhe rezultatin perfundimtar. Te gjitha aspektet e biznesit menaxhohen në mënyrë të sigurt, duke respektuar mjedisin sipas ligjeve në fuqi. Synimet e Degës janë jo vetëm investimet në aktive por edhe në burime njerezore, duke siguruar që të gjithë të kenë mundësi të rriten profesionalisht.

Politikat dhe due diligence

CEO dhe CFO te kompanise kane hartuar dhe kane mbikqyrur hartimin e kontrolleve e procedurave te dhenies se informacionit, kontrollit te brendshem mbi raportimin financiar ne menyre qe te jepet siguri e arsyeshme ne lidhje me saketesine e raportimit dhe pregatitjen e pasqyrave financiare ne perputhje me SKK dhe SNK.

Politikat e kontrollit te dhenies se informacionit dhe kontrollit te brendshem jane hartuar per te ofruar siguri te arsyeshme per vertetesine e informacionit te paraqitur nga shoqeria ne raportimet vjetore, raportimet e ndermjetme ose raporte te tjera. CEO i shoqerise dhe CFO kane konkluduar, bazuar ne vleresimin e tyre ne fund te periudhes se raportimit, qe kontrollet e brendshme te shoqerise mbi raportimin financiar dhe procedurat e kontrollit te dhenies se informacionit jane efektive dhe sigurojne nje pasqyrim te vertete e te besueshem te vlerave materiale.

Politikat the procedurat perfshijne mirembajtjen e regjistrimeve qe jane mjaftueshem te detajuara per te siguruar vertetesine e transaksioneve dhe pronesine e asetave te shoqerise, regjistrimet e shpenzimeve e te te ardhurave jane bere ne perputhje me rregulloren e brendshme dhe jane autorizuar nga drejtimi i shoqerise. Procedurat jane hartuar te ofrojne siguri te mjaftueshme qe transaksionet e pa autorizuar te zbulohen ne kohe.

Krahas procedurave dhe politikave te kontrollit te brendshem, Dega ka dhe konsulente te pavarur ne fushen e hidrokarbureve te cilet vleresojne rezervat e naftes ne fushen e Patos-Marinzes. Bazuar ne raportet e konsulenteve Dega kryen supozimet e nevojshme per te hartuar buxhetin.

Dega kryen monitorime dhe raportime mujore, tremujore dhe vjetore mbi shendetin, sigurine dhe mbrojtjen mjedisore. Informacioni per shendetin dhe sigurine ofron nje pamje te qarte mbi numri e incidenteve te regjistruara ne pune te ndara ne kategori ne varesi te demit dhe ndihmes se ofruar. Dega ben perpjekje te vazhdueshme per te permiresuar programin e sigurise brenda kompanise me qellim reduktimin e frekuences se incidenteve.

Dega eshte e lidhur ngushte me mjedisin ku operon. Monitorohen ne menyre te vazhdueshme zhurmat, uji, ajri ne perputhje me ligjin per mjedisin. Monitorohen dhe menaxhohen niveli i fluidit ne gropat ekologjike dhe impjantit te trajtimit te baltes (argjiles); vazhdon implementimi dhe zbatimi i teknologjive te reja per te asistuar ne menaxhimin e mbetjeve ne impiante. Monitorohen te gjitha incidentet mjedisore, derdhjet dhe ankesat nga komuniteti. Dega kryen marrjen e kampioneve dhe kryerjen e analizave per ujrat siperfaqesore dhe nentokesore cdo tremujor.

Rreziqet kryesore dhe menaxhimi i tyre

Dega operon ne tregjet nderkombetare dhe ato vendase. Tendencat kryesore qe mund te ndikojne ne rezultatin e shoqerise ne te ardhmen jane:

- Paqendrueshmeria e çmimit te tregut te naftes bruto;
- Rreziqet e qenesishme ne veprimtarine e naftes dhe gazit;
- Pasigurite qe lidhen me vleresimin e rezervave te naftes dhe gazit natyror;
- Konkurencen, nder te tjera, per sigurimin e kapitalit, rezervave, toka te pazhvilluara dhe personel te kualifikuar;
- Aftesia e Deges per te mbajtur qirate gjate shpimit dhe zgjerimit;
- Probleme gjeologjike, teknike, shpimi dhe procesimi;
- Luhatjet ne kursin e kembimit apo interesave;
- Kostoja ne rritje e krahut te punes dhe pajisjeve;
- Ndryshimet ne legjislacionin tatimor dhe programeve te incentives ne industrine e naftes dhe gazit natyror.

Menaxhimi i riskut financiar

Aktivitetet e Degës ekspozohen ndaj shumë rreziqeve financiare që mund të vijnë si pasojë e kërkimit, zhvillimit, prodhimit dhe aktiviteteve financiare të tilla si:

- (a) Rreziku i kredisë;
- (b) Rreziku i likuiditetit; dhe
- (c) Rreziku i tregut;

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Degës ndaj secilit prej rreziqeve më sipër, objektivave, politikave dhe proceseve të saj për matjen dhe administrimin. Përgjatë këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur shënime sasiore shtesë.

Bordi i Drejtorëve të shoqërisë mëmë të ndërmjetme mbikëqyr vendosjen dhe zbatimin nga drejtimi të strukturës së administrimit të rrezikut të Degës. Drejtimi ka zbatuar dhe monitoruar përputhshmërinë me politikat e administrimit të rrezikut. Politikat e administrimit të rrezikut të Degës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ajo përballlet, për të vendosur kufizimet dhe kontrollin e duhur të rrezikut, dhe për të monitoruar rrezikun dhe përputhshmërinë me kushtet e tregut të aktiviteteve të saj.

(a) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare të Degës nëse një klient ose palë tjetër e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe lidhet kryesisht me të arkëtueshmet e Degës nga rafineritë e naftës ose autoritetet tatimore.

Vlera kontabël e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera të arkëtueshme përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Më 31 dhjetor 2021, Dega ka përdorur zbatimin e metodës së humbjes së pritur të kredisë (HPK) në vlerësimin e zhvlerësimit të arkëtueshmeve dhe nuk është kërkuar asnjë zhvlerësim i të arkëtueshmeve.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 vjetërsia e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera që nuk ishin zhvlerësuar ishte si më poshtë:

	Aktuale	30-60 ditë	61-90 ditë	Mbi 90 ditë	Totali
2021					
Rafineritë e naftës	1,192,567	-		17,266	1,209,832
TVSH	1,350,440	-		-	1,350,440
Totali	2,543,007	-		17,266	2,560,272
2020					
Rafineritë e naftës	21,619	-		19,574	41,193
TVSH	4,260,347	-		-	4,260,347
Totali	4,281,966	-		19,574	4,301,540

Dega konsideron me vonesë çdo shumë të arkëtueshme nga rafineritë e naftës me ditë vonesa më të mëdha se 60 ditë. Llogaritë e arkëtueshme përfshirë në tabelën më lart, me ose pa vonesë, nuk janë zhvlerësuar. Ato janë me palë të treta me të cilat Dega ka një histori arkëtimesh dhe i konsideron këto llogari si të mbledhshme. Të arkëtueshmet brenda vendit kanë afat pagese në fund të muajit që pason prodhimin dhe të arkëtueshmet nga eksportet arkëtohen brenda 30 ditëve nga data e dërgesës. Politika e Degës për të zbutur rrezikun e kredisë që lidhet me të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera është krijimi i marrëdhënieve të marketingut me një sërë klientësh.

Totali i të arkëtueshmeve prej rafinerive të naftës, përfshin shumën prej 1,210 milionë Lekë (2020: 41 milionë Lekë) me afat pagese 30 ditë, nga të cilat 1,210 milionë Lekë janë arkëtuar pas 31 dhjetorit 2021.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) i arkëtueshëm rimbursohet nga autoritetet tatimore pas kontrollit të tyre verifikues. Drejtimi pret të rikuperojë të gjithë shumën e mbetur të TVSH-së së arkëtueshme.

Më 31 dhjetor 2021, Dega kishte të arkëtueshme nga autoritetet tatimore për TVSH të arkëtueshme vlerën prej 1,350 milionë Lekë (2020: 4,260 milionë Lekë) dhe shuma të parapaguara ndaj autoriteteve tatimore dhe doganore përkatësisht për parapagime të tatimit mbi fitimin dhe taksave të karbonit dhe të qarkullimit (K&Q) në një shumë totale prej 12,468 milionë Lekë (2020: 11,380 milionë Lekë).

Dega është e përfshirë në mosmarrëveshje dhe rivlerësime të ndryshme me Qeverinë Shqiptare për çështje që, ndër të tjera, lidhen me deklarime tatimore, rikuperimin e kostove dhe taksave të K&Q. Ndërkohë që drejtimi beson se të gjitha shumat e arkëtueshme dhe të parapaguara janë të rikuperueshme në tërësinë e tyre, ekziston pasiguri në lidhje me arkëtueshmërinë përfundimtare dhe rikuperimin e këtyre shumave si dhe me kohën se kur ato do të paguhen. Korrigjimet për zgjidhje të mosmarrëveshjeve dhe vlerësimeve do të reflektohen në pasqyrat financiare kur ato të bëhen të ditura ose të pritshme apo kur pritshmëritë e drejtimit të ndryshojnë.

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Dega do të ndeshet me vështirësi në përmbushjen e obligimeve të lidhura me detyrimet e saj financiare që shlyhen me anë të transferimit të mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare. Përqasja e Degës për të administruar likuiditetin është që të sigurohet sa më shumë të jetë e mundur që do të ketë likuiditet të nevojshëm në përmbushjen e detyrimeve kur ato duhet të paguhen, si në situatë normale ashtu dhe në vështirësi, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e reputacionit të saj.

Zakonisht Dega sigurohet që do të ketë mjete monetare të mjaftueshme për të përmbushur shpenzimet operative të pritshme për një periudhë minimale prej 30 ditësh, përfshirë shërbimin e detyrimeve financiare; kjo përjashton ndikimin e rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, si për shembull katastrofat natyrore. Për të arritur këtë objektiv, Dega përgatit buxhete vjetore të shpenzimeve kapitale, të cilat monitorohen vazhdimisht dhe modifikohen kur konsiderohet e nevojshme.

Për më tepër, Dega përdor autorizime për shpenzime në projektet operative dhe jo operative për të administruar më tej shpenzimet kapitale. Për të lehtësuar programin e shpenzimeve kapitale, Dega ka mundësi financimi pa interes të siguruara nga Grupi. Dega gjithashtu tenton të përshtatë ciklin e pagesave me arkëtimet e të ardhurave nga nafta.

Afatet kontraktuale të detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

31 dhjetor 2021	Flukset kontraktuale monetare				
	Vlera Kontabël	Totali	Deri në 3 muaj	Më shumë se tre muaj	Pa-përcaktuar
Të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura	5,217,867	5,217,867	5,217,867	-	-
Të pagueshme ndaj palëve e lidhura	33,668,732	33,668,732	-	-	33,668,732
Huamarrje	35,873	35,873	-	35,873	-
Detyrime qiraje	194,144	194,144	-	149,611	-
	39,116,616	39,116,616	5,217,867	185,484	33,668,732

31 dhjetor 2020	Flukset kontraktuale monetare				
	Vlera Kontabël	Totali	Deri në 3 muaj	Më shumë se tre muaj	Pa-përcaktuar
Të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura	6,779,443	6,779,443	6,779,443	-	-
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	33,974,976	33,974,976	-	-	33,974,976
Huamarrje	624,018	624,018	480,503	143,515	-
Detyrime qiraje	152,888	152,888	-	152,888	-
	41,531,325	41,531,235	7,259,946	296,403	33,974,976

Detyrimet financiare ndaj palëve të lidhura në tabelat e mësipërme pasqyrojnë marrëveshjet aktuale kontraktuale ndërmjet Degës dhe Degës mëmë të ndërmjetme dhe këto flukse monetare mund të ndodhin shumë më herët, ose në një vlerë shumë të ndryshme nëse palët vendosin më pas të rishikojnë marrëveshjet kontraktuale për detyrimet e pagueshme.

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit, normat e interesit, çmimet e naftës, të ndikojnë të ardhurat e Degës ose vlerën e instrumenteve të saj financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të drejtojë dhe kontrollojë ekspozimin e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin.

(i) Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit është rreziku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme do të luhetet si rezultat i ndryshimeve në kurset e këmbimit. Ekspozimi i Degës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në shumat ekuivalente në Lekë në datën e raportimit është si më poshtë:

(Në mijë Lekë)	31 dhjetor 2021				
	USD	Lekë	Euro	Të tjera	Total
Aktive financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalente	5,527,850	209,549	6,712	4	5,744,115
Shuma për çështje gjyqësore	-	13,296,013	-	-	13,296,013
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	171,668	-	-	-	171,668
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	1,192,566	1,367,705	-	-	2,560,271
Totali i aktiveve financiare	6,892,084	14,873,267	6,712	4	21,772,067

Detyrimet financiare

Të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura

Hua

Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Totali i detyrimeve financiare**Pozicioni neto**

1,459,003	3,425,673	317,269	13,621	5,215,566
35,873	-	-	-	35,873
33,668,732	-	-	-	33,668,732
35,163,608	3,425,673	317,269	13,621	38,920,171
(28,271,524)	11,447,594	(310,557)	(13,617)	(17,148,104)

31 dhjetor 2020

(Në mijë Lekë)

Aktive financiare

Mjete monetare dhe ekuivalentë

Shuma për çështje gjyqësore

Të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Totali i aktiveve financiare

USD	Lekë	Euro	Të tjera	Total
26,041	2,863	537	94	29,535
-	12,980,671	-	-	12,980,671
162,483	-	-	-	162,483
41,193	4,260,348	-	-	4,301,541
229,717	17,243,882	537	94	17,474,230

Detyrimet financiare

Të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura

Hua

Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Totali i detyrimeve financiare**Pozicioni neto**

2,349,303	3,954,274	459,814	16,052	6,779,443
624,018	-	-	-	624,018
33,974,976	-	-	-	33,974,976
36,948,297	3,954,274	459,814	16,052	41,378,437
(36,718,580)	13,289,608	(459,277)	(15,958)	(10,966,440)

Ekspozimi neto në USD përbëhet kryesisht nga shuma të pagueshme për palët e lidhura të cilat janë të përcaktuara në USD dhe rreziku valutor prej tyre administrohet në nivel Grupi. Kurset e mëposhtme të këmbimit janë aplikuar:

	Kursi mesatar		Kursi në fund viti	
	2021	2020	2021	2020
Lekë/USD	103.52	108.65	106.54	100.84
Euro/USD	0.84	0.88	0.88	0.82
CAD/USD	1.25	1.34	1.27	1.27

Analiza e ndjeshmërisë

Si rezultat i ekspozimit në lekë me autoritetet shqiptare, rezultati i Degës është më i ndjeshëm ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit Lek/USD. Në vitin 2021, forcimi i Lekut ndaj USD (2020: dobësimi i Lekut ndaj USD) rezultoi në një fitim neto nga kursi i këmbimit prej 979 milionë Lekë (2020: humbje neto nga kursi i këmbimit prej 802 milionë Lekë). Një forcim (dobësim) i arsyeshëm i Euro dhe Lek ndaj USD më 31 dhjetor mund të ndikojë matjen e instrumenteve financiarë që janë në monedhë të huaj si dhe fondet neto dhe fitimin ose humbjen me vlerat e paraqitura më poshtë:

	Fitim ose humbje	
	Forcim	Dobësim
31 dhjetor 2021: Euro (lëvizje 10%)	(31,650)	31,650
Lekë (lëvizje 10%)	1,144,759	(1,144,759)
31 dhjetor 2020: Euro (lëvizje 10%)	(54,325)	54,325
Lekë (lëvizje 10%)	271,625	(271,625)

(i) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që flukset monetare të ardhshme të luhaten nga ndryshimet e normës së interesit të tregut. Më 31 dhjetor 2021, Dega ka hua me interes dhe detyrime qiraje në një vlefte jo materiale dhe vlereson që nuk është e ekspozuar ndaj luhatjeve të normave të interesit.

(ii) Rreziku i çmimit të naftës

Rreziku i çmimit të naftës është rreziku që flukset e ardhshme dhe të ardhurat e Degës do të luhaten si rezultat i ndryshimeve në çmimin e naftës. Çmimet e naftës ndikohen jo vetëm nga marrëdhënia e Lekut Shqiptar me Dollarin Amerikan por gjithashtu nga ngjarjet ekonomike botërore që diktojnë nivelin e kërkesës dhe ofertës. Të ardhurat kryesore të Degës janë nga shitja e naftës së papërpunuar, me një çmim të bazuar në çmimin e naftës Brent, i ndryshuar sipas cilësisë. Më 31 dhjetor 2021, një ndryshim prej 1\$ për fuçi në çmimin e naftës së papërpunuar Brent, me të gjithë elementët e tjerë të mbajtur konstantë, do të ndikonte rezultatin neto pas tatimit për vitin me 135 milionë Lekë (2020: 152 milionë Lekë).

Treguesit kryesorë të performancës (TKP-të)

- Numri i puseve aktiv në fund të vitit 2021 ishte 574.
- Çmimi mesatar i shitjes për 2021, ishte \$70.91 për fuçi (duke përfaqësuar rreth 79% të çmimit Brent prej \$56.26 për fuçi), krahasuar me \$33.50 për fuçi (duke përfaqësuar 80% të çmimit Brent prej \$41.84 për fuçi) në 2020. Eksporti për 2021 përfaqësonte rreth 87% të totalit të shitjeve dhe 10% e naftës Bruto u shit në tregun vendas dhe 3% ju dha Albpetrol si pagesë në natyrë për shlyerjen e detyrimit të prodhimit të gjykuar (PPE).
- Shpenzimet kapitale në 2021 u ulën në vlerën \$13 milion, duke pësuar një rënie prej 35% krahasuar me ato të vitit 2020. Shume nga shpenzimet kapitale janë nën buxhetin e parashikuar. Secili nga projektet që është nën buxhet është si rezultat i vonësive në dergimin e materialeve, por në fokus ka qenë përdorimi i pajisjeve të përdorura që janë në dispozicion në vendburim, për aq sa është e mundur, për të kryer disa pjesë të projektit në vend që të bliheshin pajisje të reja.
- Aktiviteti i shpimit për vitin 2021, është nën buxhet për shkak të ndërprerjes së perkohshme të investimeve si pasojë e pandemisë globale të COVID-19.
- Marrëdhëniet me komunitetin kanë qenë nën buxhet për tremujorin e katërt për shkak të kohës së realizimit të projekteve, pasi shumë nga projektet e departamentit për MK janë realizuar përpara tremujoreve.

- Projektet per impiantet kane qene ne pergjithesi nen buxhetin e parashikuar edhe pse shume projekte kane nisur dhe jane realizuar me mberritjen e materialeve. Negocimet ne lidhje me cmimin per materialet dhe fuqine punetore kane qene arsyet kryesore perse projektet per impiantet kane qene nen buxhet. Ndertimi i shesheve ishte nen buxhet pasi kompania ka qene e fokusuar ne shpimin e puseve ne sheshet ekzistues ne vend qe te ndertohen sheshe te reja pusesh.
- Prodhimi mesatar gjate vitit 2021 shkoi ne 10,393 fuçi ne dite, 10% me pak krahasuar me prodhimin mesatar te vitit paraardhes.
- Shitjet arriten vleren mesatare prej 10,612 fuçi ne dite, 25% me pak krahasuar me vitin paraardhes. Inventari ne fund te vitit u rrit ne 288,000 fuçi krahasuar me 368,000 fuçi ne 2020.
- Te Ardhurat Neto nga Shitjet (duke perjashtuar holluesin si element per shitje) per 2021 ishin US\$218 milion krahasuar me US\$136 milion te parashikuara ne Buxhet, e cila eshte rreth 60% mbi parashikimin e bere ne Buxhet. Tejkalmimi i te ardhurave krahasuar me parashikimet vjen per shkak te rritjes se çmimit Brent te naftes se paperpunuar ne tremujorin e katert te 2021.
- Shpenzimet Operative ('Opex') per kete vit ishin US\$55 milion e cila eshte rreth 10% nen parashikimin ne buxhet prej US\$61 milion. Kjo bazuar ne vleren e korrigjuar te Opex per reduktimin ne inventarin e naftes gjate ketij viti. Luhata e ketyre kostove eshte ciklike nga tremujori ne tremujor. Ulja e shpenzimeve lidhet ngushte edhe me renien e prodhimit per shkak te kushteve jo te favorshme te ndikuara nga pandemia COVID-19. Kostot e solucionit te polimerit gjate gjithe vitit 2021 ishin me te ulta se parashikimet per shkak se prodhimi nga disa puse ishte me viskozitet te ulet. Kostot per riparimin dhe mirembajtjen pesuan ulje gjate vitit kryesisht per shkak te perdorimit te burimeve te brendshem per te kryer me shume riparime ne ofcinat e mirembajtjes se Bankers.
- Ne pergjithesi, Bankers po ben perpjekje serioze per te ulur strukturen e kostove ne cfaredolloj menyre te mundshme ne menyre qe kompania te kete fitim dhe rezultatet ne lidhje me keto perpjekje mund te shihen qarte ne kostot aktuale.
- Ne total renta per vitin 2021 perbejne rreth 14% te te ardhurave nga nafta. Luhatjet e cmimit tek renta ne baze fucie jane si rezultat i luhatjeve te cmimit te naftes.
- Te Ardhurat Neto Operative, duke perjashtuar kostot P&A para Capex, Shpenzimeve, Zhvleresimeve, dhe Amortizimeve (SHZH&A) ishin US\$119 milion krahasuar me parashikimin e bere prej US\$48 milion Kjo eshte mbi parashikimin e bere me 146%.

Aspektet tematike

a. Çështjet mjedisore

Dega eshte e lidhur ngushte me mjedisin ku operon. Ne fokus jane shendeti, siguria dhe mireqenia e punonjesve. Keto standarte pasqyrohen ne menyren e zhvillimit te biznesit. Dega eshte perqendruar ne zbatimin e standarteve kombetare dhe nderkombetare per mjedisin, shendetin dhe praktiket e sigurise ne te gjitha veprimtarite. Dega synon permiresimin e kushteve per te mbrojtur njerezit, komunitetin dhe duke pakesuar gjurmen mjedisore te veprimtarise. Bankers promovon nje filozofi te pastrimit te vazhdueshem per te zvogeluar rreziqet mjedisore dhe per te permiresuar kushtet e aktiveve ne teresi.

Informacion Mjedisor per 2021:

- Mbikqyrja dhe inspektimet e shesheve, perfshi inspektimet per ujin, monitorimi i zhurmave dhe kampionimi i ajrit, auditim per perputhshmerine ligjore mjedisore, inspektim i shesheve te marra me qira dhe shesheve te puseve.
- Monitorimi dhe menaxhimi i nivelit te fluidit ne gropat ekologjike dhe impiantin e trajtimit te baltes; po vazhdohet me zbatimin e teknologjive te reja per te asistuar me menaxhimin e mbetjeve ne keto impiante.

- Vazhdon monitorimi dhe pergjigjja ndaj incidenteve mjedisore dhe derdhjeve; dhe ankesave qe vijne nga komuniteti.
- Takimet per SHSM me Kontraktoret.
- Supervizimi dhe menaxhimi i inspektimeve te vazhdueshme per permbushjen e kerkesave ligjore per informacion.
- Operacionet ne Impiantin per Menaxhimin e Mbetjeve, vazhdon ndarja e mbetjeve, operacionet e riciklimit dhe djegies ne zonen e mbetjeve plastike.
- Vazhdon pergatitja e dokumentave per perputhshmerine ligjore.

Programi i Monitorimit Mjedisor per 2021

- Monitorimi i cilesise se Ajrit – vazhdon monitorimi pasiv i cilesise se ajrit.
- Marrja e kampioneve dhe berja e analizave per ujrat siperfaqesor dhe nentokesor.
- Raporti i Monitorimit eshte kryer nga kontraktoret lokal.

b. Çështjet sociale dhe të punonjësve

Si me poshte nje pershkrim i shkurter:

- Numri i incidenteve me humbje kohe per BPAL per tremujorin e katert ishte 00.
- Numri i incidenteve ku nevojitet ndihma e pare ishte 00, Incidenteve per kujdes mjekesor 02 dhe 00 incidente kryesisht me vendin e punes.
- Numri i incidenteve me mjete motorik te regjistruara per tremujorin e katert ishte 02, perkatesisht: 01 te kryera nga mjetet e BPAL 01 te kryera nga mjetet e kontraktoreve.
- Numri i incidenteve me demtim prone te regjistruara per tremujorin e katert eshte 00.
- Numri i incidenteve me humbje kohe te regjistruara per tremujorin e kater eshte 01.
- Numri i incidenteve te paregjisrtuara per tremujorin e katert eshte 01.
- Detaje ne lidhje me keto incidente jane prezantuar ne Progres Raportin mujor, shikoni edhe ndarjet per keto incidente ne tabelen e meposhtme.
- Bankers po ben perpjekje per te permiresuar programin e sigurise brenda kompanise me qellim reduktimin e frekuences se incidenteve.
- Kontraktoret po bejne perpjekje per te permiresuar programin e sigurise me qellim reduktimin e frekuences se incidenteve.

Incidente Humbje kohe	Tremujori Paraardhes (Q3-2021)	Tremujori Aktual (Q4-2021)	Kumulative Viti (nga 01-Jan-2021)		Kumulative (nga 20-korrik-2004)	
			Incidente	Freq *	Incidente	Freq *
Bankers	0	0	2	2.036	18	1.321
Kontraktore	0	1	1	0.570	59	1.470

Raporti i Audituesit te Pavarur

Për **Drejtimin dhe Ortakun e**
Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Rr.Leonardo Murialdo, Gd.37
Fier - Shqipëri

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **“Bankers Petroleum Albania Ltd” – dega në Shqipëri** (Dega), të cilat përfaqësojnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur me datën 31 Dhjetor 2021, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të degës **“Bankers Petroleum Albania Ltd”**, me datën 31 Dhjetor 2021, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Baza për Opinionin

Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi te pavarur nga Dega në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Pasiguri Materiale në Lidhje me Vijimësinë

Ne tërheqim vëmendjen tek shënimet 2 i pasqyrave financiare që përshkruan se Dega ka deficit në kapitalin qarkullues prej 28,660 milion lekë (2020: 35,227 milion lekë), të cilat lidhen tërësisht me shuma që i detyrohen palëve të lidhura. Ashtu siç pohohet në shënimin 2, këto ngjarje ose kushte, së bashku me çështje të tjera siç janë paraqitur në shënimin 2, tregojnë për ekzistencën e një pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Degës për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Opinionin ynë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Informacione të tjera

Drejtimi ka përgatitur raportet e tjera në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 date 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si pjesë përbërëse e raportimit financiar. Përgatitja e këtyre raporteve, informacione të tjera, është përgjegjësi e drejtimit dhe nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin e audituesit të pavarur për këto pasqyra. Opinioni jonë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe nuk shprehim asnjë formë opinioni mbi to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera dhe, duke bërë këtë, marrim parasysh nëse informacioni është materialisht i papajtueshëm me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra gjatë procesit të auditimit ose të ketë anomali materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit. Nëse, gjatë punës së kryer për auditimin e pasqyrave financiare, ne eidentojmë një anomali materiale në informacionet e tjera, ne kemi detyrim ta raportojmë atë. Ne nuk kemi asnjë cështje për të raportuar për informacionet e tjera.

Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të dhe Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Degës për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Degën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona të auditimit janë: të arrijmë një siguri të arësyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili përfshin opinionin e auditusit. Siguria e arësyeshme megjithatë është një siguri e nivelit të lartë, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojmë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku pritet, që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Nje auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kerkon qe ne si auditues te ushtrojmë gjykimin profesional dhe te ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i anomalise materiale si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara ose anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Kur arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audituesi Ligjor

Për Studio L.E.A.L. Auditing shpk
Rr.e Barrikadave, Galeria, H.11, Ap.18
Tiranë- Shqipëri

Leze ABAZI
Audit Partner

Tiranë më, 15 Shtator 2022



Bankers Petroleum Albania Ltd
Dega në Shqipëri

Pasqyrat Financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(me raportin e Audituesve të Pavarur bashkëngjitur)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesve të Pavarur	i - iii
Pasqyrat financiare	
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	1
Pasqyra e pozicionit financiar	2
Pasqyra e ndryshimeve në fondet neto	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	5 – 33

Pasqyra e te ardhurave gjithperfshirese

	Shënime	<i>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor</i>	
		2021	2020
Të ardhurat		22,516,038	14,930,332
Pagesa për të drejta minerare		(3,211,432)	(2,067,737)
Të ardhura neto	9	19,304,606	12,862,595
Shpenzime operative	10	(5,612,272)	(5,751,070)
Shpenzime të shitjes dhe transportit	11	(1,326,236)	(1,272,259)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	12	(1,278,434)	(1,471,360)
Amortizimi dhe harxhimi	20	(5,281,521)	(6,370,151)
Pagesa bazuar në aksione		-	-
Totali i shpenzimeve operative		(13,498,463)	(14,864,840)
Fitimi (humbja) operativ		5,806,143	(2,002,245)
Të ardhura/(shpenzime) financiare neto	13	(1,098,451)	610,893
Humbja përpara tatimit		(4,707,692)	(1,391,352)
Te ardhura/(shpenzimi) i tatimit mbi fitimin	14	(2,196,064)	1,595,113
Fitimi për vitin		2,511,628	203,761
Të ardhura të tjera përmbledhëse			
Diferenca përkthimi		2,178,613	(2,880,955)
Fitimi (humbja) përmbledhëse e vitit		4,690,241	(2,677,194)


Shënimet në faqet 5 – 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Bankers Petroleum Albania Ltd. – Dega në Shqipëri**Pasqyra e pozicionit financiar***(Shumat janë në Lek'000)***Pasqyra e Pozicionit financiar**

	Shënime	2021	2020
Aktive			
Afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalentë	15	5,744,113	29,535
Shuma dhe shpenzime të parapaguara	16	1,211,412	1,126,616
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	17	2,560,272	4,301,541
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	18	171,668	162,483
Inventarë	19	769,055	576,201
		10,456,520	6,196,376
Afatgjata			
Shuma të parapaguara afatgjata	16	13,942,465	12,980,457
Aktive afatgjata materiale	20	100,809,754	99,177,123
		114,752,219	112,157,580
Totali i aktiveve		125,208,739	118,353,956
Detyrime			
Afatshkurtra			
Hua	21	35,873	624,018
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	18	33,668,732	33,974,976
Të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura	22	5,217,867	6,779,443
Detyrime qiraje pjesa afatshkurter	26	44,533	45,075
		38,967,005	41,423,512
Afatgjata			
Detyrime qiraje	26	149,611	107,813
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi	23	5,506,492	5,134,303
Detyrim për tatimin e shtyrë	14	38,650,080	34,443,018
		44,306,183	39,685,134
Totali i detyrimeve		83,273,188	81,108,646
Fonde neto			
Rezervë përkthimi		1,946,502	(232,111)
Fitim i pashpërndarë		39,989,049	37,477,421
		41,935,551	37,245,310
Totali i detyrimeve dhe fondeve neto		125,208,739	118,353,956

Shënimet në faqet 5 – 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri janë miratuar nga Drejtimi më 14 shtator 2022 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:


 Huangm Xiao
 Administrator



 Quanjun Tang
 Drejtor Finance

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Pasqyra e ndryshimeve në fonde neto
(Shumat janë në mijë Lekë)

	Kontribut shtesë	Rezervë përkthimi	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2020				
Totali i të ardhurave përmbledhëse	-	2,648,844	37,273,660	39,922,504
Fitimi i vitit	-		203,761	203,761
Të tjera humbje përmbledhëse	-	(2,880,955)	-	(2,880,955)
Totali i fitimit (humbjes) përmbledhëse për vitin	-	(2,880,955)	203,761	(2,677,194)
Transaksione me pronarët e degës				
Kontribute dhe shpërndarje				
Pagesa bazuar në aksione	-	-	-	-
Opsione të aksioneve dhe aksione të kufizuara të ushtruara	-	-	-	-
Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	(232,111)	37,477,421	37,245,310
Totali i të ardhurave përmbledhëse				
Fitimi i vitit	-	-	2,511,628	2,511,628
Të tjera fitime përmbledhëse	-	2,178,613	-	2,178,613
Totali i fitimit përmbledhës për vitin	-	2,178,613	2,511,628	4,690,241
Gjendja më 31 dhjetor 2021	-	1,946,502	39,989,049	41,935,551

Shënimet në faqet 5 – 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Flukseve Monetare

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
		2021	2020
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
Fitim para tatimit		4,707,692	(1,391,352)
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi dhe harxhimi	20	5,281,521	6,370,151
Rritja nga skontimi i detyrimit për nxjerrje nga përdorimi	13	102,921	146,411
(Fitim)/humbje nga kursi këmbimit	13	978,781	(802,161)
Të ardhura interesi	13	-	-
Shpenzime interesi	13	7,255	27,797
		11,078,170	4,350,846
<i>Ndryshime në:</i>			
Mjete monetare të ngurtësuara		-	127,307
Shuma dhe shpenzime të parapaguara		(926,772)	701,272
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera		1,761,171	1,117,058
Inventarë		(155,738)	(125,760)
Të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura		(2,017,000)	(3,277,778)
Flukse monetare nga aktivitetet operative		9,739,831	2,892,945
Interes i arkëtuar		-	-
Interes i paguar		(7,255)	(27,797)
Flukse monetare neto nga aktivitetet operative		9,732,576	2,865,148
Flukse monetare nga aktivitet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale, aktiveve të kërkimit dhe vlerësimit		(1,369,104)	(2,308,233)
Flukse monetare neto të përdorura për aktivitetet investuese		(1,369,104)	(2,308,233)
Flukse monetare nga aktivitetet financuese			
Pagesa të qirave	26	(43,318)	(48,575)
Pagesa të huave, neto	21	(605,736)	130,252
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		(2,163,535)	(654,413)
Flukse monetare neto nga aktivitetet financuese		(2,812,589)	(572,736)
Rritje/(ulje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë		5,550,883	(15,821)
Mjete monetare dhe ekuivalentë më 1 janar		29,535	38,871
Efekti neto nga përkthimi në monedhë të huaj		163,695	6,485
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	15	5,744,113	29,535

Shënimet në faqet 5 – 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. NJËSIA RAPORTUESE

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri (“Dega”) është krijuar si degë e Bankers Petroleum Albania Ltd. (“Shoqëria mëmë”), një shoqëri e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve të Ishujve Cayman. Dega është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Shqipëri më 28 korrik 2004, dhe është e angazhuar në kërkimin dhe prodhimin e naftës në Shqipëri.

Mëma është plotësisht në pronësi të Bankers Petroleum International Limited, një shoqëri e themeluar në Jersey dhe e zotëruar 100% nga Bankers Petroleum Ltd. (“Shoqëria mëmë e ndërmjetme”), një shoqëri e themeluar në Kanada. Shoqëria mëmë perfundimtare është Charter Power Investment Limited, një shoqëri e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve të Hong Kongut.

Dega operon në fushën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës në pajtim me Marrëveshjen Hidrokarbure dhe ndryshimet e mëvonshme, të nënshkruara midis mëmës dhe Albpetrol Sha (Albpetrol), shoqëri e naftës në pronësi shtetërore, nën licencën ekzistuese të Albpetrolit me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Marrëveshja e Patos-Marinzës u bë efektive në mars 2004 dhe ka një afat 25 vjeçar me opsionin për t’u zgjatuar dhe për pesë vite të tjera, me zgjedhjen e shoqërisë mëmë, pas miratimit të qeverisë dhe organeve rregullatore.

2. BAZAT E KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare të Degës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Parimi kontabël i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë që supozon se Dega do të jetë në gjendje të përmbushë shlyerjen e detyrimeve të saj afatshkurtra dhe të pagueshmet ndaj palëve të lidhura nuk do të kërkohen për shlyerje më herët se një periudhë të paktën, por që nuk kufizohet vetëm në, 12 muaj nga data e raportimit (shënimi 19).

Dega ka një deficit të kapitalit qarkullues prej 28,660 milion lekë (2020: 35,227 milion lekë), e cila është tërësisht e lidhur me shuma që i detyrohet palëve të lidhura. Dega kanë marrë vendime të favorshme gjyqësore lidhur me mosmarrëveshje dhe vlerësime të ndryshme (shih shënimin 14, 19) me Qeverinë Shqiptare dhe drejtimi po ndjek në mënyrë aktive arkëtimin e depozitave dhe të arkëtueshmeve me qeverinë shqiptare (shih shënimet 25 (b)).

Aftësia e Degës për të vazhduar si një biznes në vijimësi varet nga arkëtimi i depozitave dhe të arkëtueshmeve nga Qeveria Shqiptare dhe mbështetja financiare e shoqërisë mëmë. Nuk ka siguri nëse ngjarje të tilla do të ndodhin dhe nëse do ketë burime financimi në dispozicion me kushte të pranueshme për Degën. Këto çështje shkaktojnë pasiguri materiale që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Degës për të vazhduar si një biznes në vijimësi.

Këto pasqyra financiare nuk pasqyrojnë rregullimet që do të ishin të nevojshme nëse supozimi i biznesit në vijimësi nuk do të ishte i përshtatshëm. Nëse parimi i vijimësisë nuk do të ishte i përshtatshëm, atëherë do të ishin të nevojshme rregullime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të Degës, të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara dhe klasifikimet e përdorura në bilanc. Këto rregullime mund të jenë materiale.

3. MONEDHA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE

Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lek Shqiptar (“Lek”), që ndryshon nga monedha funksionale e Degës, Dollari Amerikan (“USD”). Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, nëse nuk është shprehur ndryshe.

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë vlerësime dhe të përdorë gjykimin në lidhje me shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, dhe shënimet për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në datën e pasqyrave dhe me shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit. Për shkak të natyrës së tyre, vlerësimet janë subjekt i pasigurive në matje dhe ndryshimet në këto vlerësime në periudhat e ardhme mund të kërkojnë një ndryshim material në pasqyrat financiare. Prandaj, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga shumat e vlerësuara kur ndodhja e ngjarjeve të ardhshme vërtetohet. Vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme të kryera nga drejtimi për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë si më poshtë:

(a) Rikuperimi i vlerës kontabël të aktiveve

Rikuperimi i vlerës kontabël të aktiveve të naftës vlerësohet në nivelin e njësisë gjeneruese të parasë (NJGJP). Përcaktimi se nga çfarë përbëhet një NJGJP është subjekt i gjyqimeve të drejtimit (shënim 7(d)(i) dhe 21). Përbërja e aktiveve të NJGJP-së mund të ndikojë drejtpërsëdrejti rikuperimin e aktiveve të përfshira në të. Vlerësimet kyçe të përdorura në përcaktimin e flukseve monetare nga rezervat e naftës përfshijnë sa më poshtë:

(i) Rezervat – Rezervat e vërtetuara dhe të mundshme përfaqësojnë sasitë e vlerësuara të naftës së papërpunuar, për të cilat të dhënat gjeologjike, gjeofizike dhe inxhinierike tregojnë me një shkallë të caktuar sigurie që janë të rikuperueshme në vitet e ardhshme nga rezervuarë të njohur dhe të cilat konsiderohen të jenë të prodhueshme për tregtim. Rezervat e vërtetuara dhe të mundshme vlerësohen të paktën një herë në vit nga inxhinierë të pavarur të rezervuarëve. Rezervat totale të vërtetuara dhe të mundshme më 31 dhjetor 2021 të vlerësuara nga inxhinierët e pavarur të rezervuarëve si të rikuperueshme gjatë kohës së vlerësuar të licencës paraqiten në shënimin 21. Supozimet e vlefshme në kohën e vlerësimit të rezervave mund të ndryshojnë në mënyrë të thelbësore kur të vihet në dispozicion informacion i ri. Ndryshimet në vlerësimet e çmimeve të ardhshme, kostot e prodhimit apo normat e rikuperimit mund të ndryshojnë statusin ekonomik të rezervave dhe mund të rezultojë në një riparaqitje eventuale të rezervave.

(ii) Çmimet e naftës – Vlerësimet e çmimeve të ardhshme përdoren në modelin e fluksit të parasë. Çmimet e produkteve mund të luhaten për shumë arsye që përfshijnë ofertën dhe kërkesën e produkteve kryesore, nivelet e inventarit, motin si dhe faktorët ekonomikë dhe gjeopolitikë. Vlerësimet e çmimeve të ardhshme janë paraqitur në shënimin 21.

(iii) Norma e skontimit – Norma e skontimit e përdorur për llogaritjen e vlerës aktuale neto të flukseve monetare bazohet në vlerësimin e një kostoje mesatare të ponderuar të kapitalit për shoqëri të ngjashme të industrisë. Ndryshimet në mjedisin e përgjithshëm ekonomik mund të rezultojnë në ndryshime të rëndësishme të këtij vlerësimi. Norma e skontimit e përdorur për llogaritjen e vlerës aktuale neto të rezervave të vërtetuara dhe të mundshme më 31 dhjetor 2021 është paraqitur në Shënimin 21.

(b) Harxhimi dhe amortizimi

Shumat e regjistruara për harxhimin dhe amortizimin janë bazuar në vlerësime të rezervave totale të vërtetuara dhe të mundshme të naftës dhe në shpenzimet e ardhshme kapitale të zhvillimit. Për shkak të natyrës së tyre, vlerësimet e rezervave, përfshirë vlerësimet e çmimeve, kostove dhe flukseve të ardhshme monetare, mbartin pasiguri në matje. Prandaj, ndikimi në pasqyrat financiare në periudhat e ardhshme mund të jetë i rëndësishëm.

(c) Detyrim për nxjerrje nga përdorimi

Shumat e regjistruara për detyrimin për nxjerrje nga përdorimi dhe rritja nga skontimi i detyrimit për nxjerrje nga përdorimi kërkojnë një vlerësim të shumës dhe kohës së kryerjes së shpenzimeve për nxjerrje nga përdorimi dhe të normave të përshtatshme të skontimit (shih shënimin 24). Kostot dhe flukset monetare dalëse aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet si pasojë e ndryshimeve në ligje e rregullore, pritshmëritë e publikut, kushtet e tregut, zbulimit dhe analizës së kushteve të terrenit dhe në teknologji. Provizionet e tjera njihen në periudhën kur bëhet e mundshme që do të ketë flukse monetare dalëse të ardhshme.

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

(d) Tatimi i shtyrë

Interpretimet tatimore, rregulloret dhe legjislacioni në juridiksionin ku vepron Dega janë subjekt ndryshimi. Në këtë mënyrë, tatimi mbi fitimin mbart pasiguri në matje. Aktivet tatimore të shtyra vlerësohen nga drejtimi në fund të periudhës raportuese për të përcaktuar mundësinë e realizimit të tyre nga fitimet e ardhshme tatimore.

(e) Përcaktimi i monedhës funksionale

Në përcaktimin e monedhës funksionale, kërkohet një gjykim i rëndësishëm për të konsideruar se cila është monedha e mjedisit ekonomik parësor ku vepron Dega. Në këtë gjykim, prioritet i jepet marrjes në konsideratë të treguesve parësorë dhe më pas atyre dytësorë të monedhës funksionale të një shoqërie dhe një gjykim i rëndësishëm përdoret në përcaktimin e monedhës funksionale që përfaqëson në mënyrë më të sigurtë transaksionet, ngjarjet dhe kushtet kryesore të Degës.

(f) Shuma të parapaguara ndaj autoriteteve tatimore

Dega ka shuma të parapaguara ndaj autoriteteve tatimore shqiptare në lidhje me konflikte dhe vlerësime të ndryshme tatimore si dhe për qëllime procedurale për disa çështje ligjore. Këto teprica janë në shkallë të ndryshme rishikimi nga autoritetet tatimore dhe gjykatat shqiptare. Ekziston një pasiguri në lidhje me rikuperimin përfundimtar dhe arkëtueshmërinë e këtyre shumave si dhe me kohën se kur ato do të paguhet (shënimi 17).

(g) Rreziku ligjor

Drejtimi i Degës ka krijuar një proces të brendshëm për njohjen dhe matjen e provizioneve dhe angazhimeve të lidhura me çështje ligjore aktuale ose të mundshme. Supozimet kryesore mbi mundësinë dhe madhësinë e një fluksi dalës burimesh bazohen në këshillat ligjore të brendshme dhe të jashtme duke ndjekur strategjitë përkatëse për një mbrojtje të suksesshme. Çdo veprim dhe rrezik përkatës vlerësohet sipas meritave të tij dhe detyrimi ligjor apo konstruktiv që i takon si dhe vlerësimi i flukseve dalëse monetare që konsiderohen të pagueshme, miratohen në mënyrë të pavarur nga Dega dhe drejtimi i shoqërisë mëmë të ndërmjetme (shih shënimin 25(b)).

5. BAZAT E MATJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

6. NDRYSHIME NE POLITIKAT KONTABËL

(a) SNRF 9 Instrumentet financiare

Sipas SNRF 9, instrumentet derivative për të cilat aktivi bazë është një aktiv i përfshirë në objektin e standardit, nuk ndahen. Instrumenti financiar hibrid vlerësohet dhe klasifikohet si një i tërë. SNRF 9 përgjithësisht ruan kërkesat ekzistuese të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare.

Dega ka zbatuar kategorizmin e instrumenteve financiare sipas SNRF 9 dhe Adoptimi i SNRF 9 nga ana e Degës nuk ka patur efekt të rëndësishëm në politikat kontabël të saj për detyrimet financiare.

Për më tepër shpjegime mbi mënyrën se si Dega mat dhe klasifikon instrumentet financiare dhe llogaritë për fitimet dhe humbjet e lidhura me to sipas SNRF 9, shih Shënimin 7(b).

(b) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Dega zbaton modelin e zhvlerësimit të aktiveve financiare sipas SNRF 9, i cili zëvendëson modelin e “humbjeve të pësuar” të SNK 39 me modelin e “humbjeve të pritshme të kredisë” (HPK). Modeli i ri i zhvlerësimit aplikohet për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar, aktivet kontraktuale dhe investimet në titujt e borxhit me VDAGJ por jo për investimet në titujt e pronësisë. Sipas SNRF 9, humbjet e kredisë njihen më shpejt në kohë krahasuar me SNK 39- shih Shënimin 7(e)(i). Për aktivet e përfshira në modelin e zhvlerësimit sipas SNRF 9, humbjet nga zhvlerësimi në përgjithësi pritet të rriten dhe të bëhen më të ndryshueshme.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga Dega në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare, përveçse nëse përmendet ndryshe (shih Shënimin 6).

(a) Monedha e huaj

Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e shprehura në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale të Degës, që është USD, me kurset e këmbimit të datave të transaksioneve.

Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare që maten me vlerë të drejtë në një monedhë të huaj, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit historik kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo monetarë që maten bazuar në koston historike të shprehura në monedhë të huaj përkthehen me kurset e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e këmbimit zakonisht njihen në fitim ose humbje.

Përkthimi në monedhën raportuese

Aktivet dhe detyrimet e Degës, përkthehen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare të Degës përkthehen në Lekë me një kurs të përshtatshëm mesatar këmbimi për periudhën. Diferencat nga përkthimi njihen në të ardhurat e tjera përmbledhëse dhe akumulohen në rezervën nga përkthimi i monedhës.

(b) Instrumentet financiarë

i- Njohja dhe matja fillestare

Dega njeh fillimisht të arkëtueshmet në datën kur ato lindin. Të gjithë aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit kur Dega bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit.

Dega çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar skadojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale në një transaksion me anë të cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë së aktivit financiar janë transferuar, ose me anë të cilit Dega nuk transferon dhe as ruan të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivit të transferuar. Çdo interes mbi këto aktive financiare të çregjistruara, i mbajtur apo i krijuar nga Dega, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë. Dega çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale janë përmbushur, anuluar apo kanë skaduar.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Dega ka një të drejtë ligjore aktuale të ekzekutueshme për kompensim dhe synon t'i kompensojë ato mbi baza neto ose të përfitojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

ii- Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

Aktivet financiare – Politikë e zbatueshme që nga 1 janar 2018

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet i matur me koston e amortizuar.

Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përjashtuar rastin kur Dega ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në rast të tillë, aktivet financiare të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës raportuese pasardhëse pas ndryshimit në model.

Aktivi financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson kushtet e mëposhtme dhe nuk është i përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes:

- është në një model biznesi, objektivi i të cilit është mbajtja e aktiveve për përfitimin e flukseve monetare kontraktuale; dhe
- termat kontraktuale të aktivit përcaktojnë data specifike për flukset e mjeteve monetare të cilat janë pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën totale të pashlyer.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(c) Instrumentet financiarë (vazhdim)

Aktivët financiarë - Vlerësimi i modelit të biznesit: Politikë e zbatueshme që nga 1 janar 2018.

Dega bën një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv mbahet në nivel portofoli pasi kjo mënyrë reflekton saktë drejtimin e biznesit dhe informacionin që i ofrohet Drejtimit. Informacioni përfshin:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimin e këtyre politikave në praktikë. Këtu përfshihet nëse strategjia e Drejtimit fokusohet në fitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi duke ruajtur një profil të caktuar të normës së interesit, duke përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen detyrimeve të lidhura me to ose me daljen e flukseve monetare apo duke realizuar flukse monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- se si performanca e portofolit vlerësohet dhe raportohet tek Drejtimi i Degës;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe aktivët financiarë të mbajtura brenda atij modeli të biznesit) dhe në veçanti, mënyra në të cilën këto rreziqe janë menaxhuar;
- si janë kompensuar Drejtuesit e biznesit, nëse kompensimi është i bazuar në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në bazë të flukseve monetare kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuenca, volumi dhe koha e shitjes së aktiveve financiare në periudha të mëparshme, arsyet e shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjes.

Transferimet e aktiveve financiare në palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Degës.

ii-Klasifikimi dhe matja e mepasme(vazhdim)

Aktivët financiarë- Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit. Politikë e zbatueshme që nga 1 janar 2018

Për qëllim të këtij vlerësimi, 'principal' është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' është shpërblimi për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh, rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Dega merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale e cila rezulton në mosplotësimin e këtij kushti. Gjatë vlerësimit, Dega konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve monetare;
- kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë elemente me tipare të ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Degës për flukset monetare nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme).

Një tipar parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesës vetëm për principalin dhe interesin nëse shumata e parapaguar në thelb paraqet shumata e papaguar të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, të cilat mund të përfshijnë kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës. Gjithashtu, për një aktiv financiar të blerë me zbritje apo me prim mbi shumën kontraktuale, një tipar që lejon ose kërkon parapagim për një shumë që në thelb paraqet shumën kontraktuale plus interesa kontraktuale të përlogaritur (por të papaguar), interes kontraktual (që mund të përfshijë dhe shpërblim për përfundim të parakohshëm) trajtohet si të jetë në përputhje me këtë kriter nëse vlera e drejte e tiparit të parapagimit është e parëndësishme në njohjen fillestare.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(b) Instrumentet financiarë (vazhdim)

Aktivet financiare- Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit. Politikë e zbatueshme që nga 1 janar 2018

Aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar rrjedhimisht maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kostoja e amortizuar reduktohet nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose humbje.

Aktivet financiare - Matja e mëpasshme dhe fitimet dhe humbjet: Politikë e zbatueshme para 1 janar 2018

Dega i klasifikonte aktivet financiare në Hua dhe të arkëtueshme.

Aktivet financiare - Matja e mëpasshme dhe fitim/humbjet: Politikë e zbatueshme para 1 janar 2018

Huatë dhe të arkëtueshmet mateshim me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Detyrimet financiare – Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet/humbjet

Detyrimet financiare maten fillimisht me koston e amortizuar. Pas njohjes fillestare, ato maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga interesi, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

iii-Çregjistrimi

Aktivet financiare

Dega çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit të gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar, ose me anë të së

iii-Çregjistrimi

Aktivet financiare

Dega nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Dega bëhet pjesë e transaksioneve me anë të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

Detyrimet financiare

Dega çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Dega gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast, njihet me vlerën e drejtë një detyrim i ri financiar i bazuar në kushtet e modifikuara.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jo monetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

ii- Kompensimi

Aktivet dhe Detyrimet Financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Dega ka të drejtë ligjore për të shlyer shumat dhe ka për qellim ti shlyejë ato ne baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(c) Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, që përfshijnë dhe aktivet e naftës, janë matur me kosto minus harxhimin dhe amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar të zhvlerësimit. Aktivet e naftës grupohen në NJGJP për qëllime testimi për zhvlerësim. Dega i ka grupuar aktivet e naftës në një NJGJP, fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinzës, në përputhje me licencën.

Nëse pjesë të rëndësishme të një grupi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato do të trajtohen si elementë më vete (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Çdo fitim ose humbje nga shitja apo nxjerrja nga përdorimi e një aktivi afatgjatë material njihet në të ardhura ose shpenzime.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostot që ndodhin pas përcaktimit të përshtatshmërisë fizike dhe tregtare dhe kostot e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale njihen si aktive naftë vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të aktivitetit specifik me të cilin lidhen. Të gjithë shpenzimet e tjera njihen në fitim ose humbje kur ndodhin. Kapitalizimi i aktiveve të naftës përgjithësisht përfaqëson kosto që lidhen me zhvillimin e rezervave të vërtetuara dhe/ose të mundshme dhe me mundësimin apo rritjen e prodhimit nga këto rezerva, dhe akumulohen sipas fushës ose zonës gjeo-teknike. Vlera kontabël e çdo aktivi të zëvendësuar ose të shitur çregjistrohet. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme të aktiveve afatgjata njihen në fitim ose humbje kur ndodhin.

(iii) Harxhimi dhe amortizimi

Vlera kontabël e aktiveve të naftës harxhohet duke përdorur metodën e njësive të prodhimit si raport i prodhimit gjatë vitit ndaj rezervave përkatëse të vërtetuara dhe të mundshme, duke marrë në konsideratë kostot e ardhshme të vlerësuara të zhvillimit të nevojshme për të kthyer këto rezerva në prodhim. Këto vlerësime rishikohen nga inxhinierë të pavarur rezervuarësh së paku çdo vit.

Për aktive të tjera, amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare ose me atë zbritëse përgjatë jetëgjatësisë së dobishme të vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale. Toka nuk amortizohet. Kostot e ndërhyrjes në puse amortizohen me metodë lineare për 5 vite. Pajisjet, mobiljet dhe instalimet amortizohen me metodën zbritëse me norma nga 20% deri në 25%. Metodatat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi.

(d) Inventarët

Inventarët përbëhen nga naftë e papërpunuar, hollues, karburant dhe inventar tjetër që vlerësohet me vlerën më të ulët mes koston mesatare të prodhimit dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme vlerësohet me çmimin e shitjes në veprimtarinë normale të biznesit minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

(e) Zhvlerësimi

i- Aktive financiare jo-derivative

Politikë e aplikueshme që nga 1 janar 2018

Instrumentet financiarë

Dega njih një zbritje për HPK për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar dhe mat provizionet e humbjeve në një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivitetit. Dega e konsideron një aktiv financiar në rrezik mosshlyerje kur:

- kundërpartia ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Degës pa masa shtrënguese nga ana e Degës siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;
- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

HPK përgjatë gjithë jetës së aktivitetit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar. Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të HPK është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Dega është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Zhvlerësimi (vazhdim)

Matja e HPK

HPK janë një vlerësim i ponderuar me probabilitetin i humbjeve të kredisë. Humbjet e kredisë janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (diferenca mes flukseve monetare kontraktuale dhe mjeteve monetare që Dega pret të arkëtojë).

Aktivitet financiar të zhvlerësuar

Në çdo datë raportimi, Dega vlerëson nëse aktivet financiare të mbartura me koston e amortizuar janë të zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka ndodhur një ose më tepër ngjarje që kanë ndikim të ndjeshëm në flukset monetare të ardhshme. Evidencë se një aktiv financiar është i zhvlerësuar përfshin të dhënat e vëzhgueshme vijuese:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit;
- shkelje e kontratës ose debitori është më tepër se 90 ditë me vonesë në kryerjen e pagesës;
- është e mundur që debitori do të falimentojë ose do të riorganizohet financiarisht;

Paraqitja e zbritjes për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar.

Humbjet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Dega nuk ka pritshmëri për rikuperimin total ose të pjesshëm të aktivit financiar. Dega bën një vlerësim në lidhje me kohën dhe shumën e fshirjes duke patur parasysh mundësinë e arsyeshme të rikuperimit. Dega nuk pret rimarrje të konsiderueshme nga shuma e fshirë. Megjithatë, aktivet financiare që janë fshirë mund të jenë ende subjekt i masave shtrënguese në përputhje me procedurat e Degës për rikuperimin e shumave të pashlyera.

ii-Aktivitet financiar jo-derivative

Politikë e zbatueshme që para 1 janar 2018

Një aktiv financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për zhvlerësim. Evidencat objektive përfshinin: mospagim ose pa-aftësi paguese nga një debitor, shenja që një debitor do të falimentojë, përkeqësime të statusit të pagesave të debitorit dhe të dhëna të verifikueshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në flukset e pritura nga aktivet financiare.

ii-Aktivitet financiar jo-derivative(vazhdim)

Dega konsideron evidencat e zhvlerësimit për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet individualisht të mëdha vlerësohen individualisht për zhvlerësim. Ato që nuk rezultojnë të zhvlerësuar vlerësohen më pas në mënyrë kolektive për ndonjë zhvlerësim të ndodhur, por ende jo të identifikuar në mënyrë individuale. Aktivet jo individualisht të mëdha vlerësohen për zhvlerësim në mënyrë kolektive. Vlerësimi kolektiv bëhet duke grupuar së bashku aktive me karakteristika rreziku të ngjashme.

Në vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv, Dega përdorte informacion historik mbi kohën e rikuperimit dhe shumën e humbjes së ndodhur, dhe bënte një rregullim në rast se kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit ishin të tilla që humbjet aktuale kishin mundësi të ishin më të mëdha ose më të vogla se ato të parashikuarat. Një humbje nga zhvlerësimi llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare, skontuar me interesin efektiv fillestar. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe reflektohen në një llogari zbritjeje nga zhvlerësimi. Kur Dega konsideron që nuk ka një perspektivë reale të rikuperimit të aktivit, shumat përkatëse fshihen.

7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Zhvlerësimi (vazhdim)

(iii)- Aktive jo financiare

Nëse më vonë shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit, humbja nga zhvlerësimi e njohur më parë rimerret në fitim ose humbje.

Vlerat kontabël të aktiveve jo financiare të Degës, përveç aktiveve të K&V dhe tatimit të shtyrë, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse një tregues i tillë ekziston, vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivitetit. Aktiviteti K&V vlerësohet për zhvlerësim kur riklasifikohet në aktive afatgjata materiale dhe gjithashtu nëse faktet dhe rrethanat sugjerojnë që vlera kontabël e tejkalon vlerën e rikuperueshme.

Për qëllime testimi për zhvlerësim, aktiviteti grupohet së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse monetare hyrëse nga përdorimi i vazhdueshëm, gjerësisht të pavarura nga flukset monetare hyrëse të aktiveve ose NJGJP-ve të tjera. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose një NJGJP-je është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë, minus kostot e shitjes.

Vlera e drejtë, minus kostot e shitjes, përcaktohet si vlera që mund të përfitohet nga shitja e një NJGJP-je në një transaksion të rregullt midis palësh të mirë informuara dhe me vullnetin e duhur. Vlera e drejtë, minus kostot e shitjes e aktiveve të naftës zakonisht përcaktohet si vlera aktuale neto e flukseve të ardhshme të vlerësuara monetare që pritet të vijnë nga përdorimi i vazhdueshëm i NJGJP-së, përfshirë çdo zgjerim në perspektivë dhe nxjerrjen nga përdorimi, duke përdorur supozimet që do të merreshin në konsideratë nga një pjesëmarrës i pavarur i tregut. Këto flukse monetare skontojnë me një normë të përshtatshme skontimi e cila do të përdorej nga një pjesëmarrës tregu për të arritur në vlerën aktuale neto të NJGJP-së.

Vlera në përdorim përcaktohet si vlera aktuale neto e flukseve të ardhshme të vlerësuara monetare që pritet të vijnë nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivitetit në formën aktuale dhe nga nxjerrja nga përdorimi. Vlera në përdorim përcaktohet duke përdorur supozime specifike të përdorimit të vazhdimësi të Degës dhe mund të marrë në konsideratë vetëm kostot e ardhshme të aprovuara të zhvillimit. Vlerësimet e flukseve të ardhshme monetare të përdorura në përcaktimin e zhvlerësimit të aktiveve bëhen duke përdorur parashikimet e drejtimit për çmimet e naftës dhe volumin e pritshëm të prodhimit. Kjo e fundit merr parasysh vlerësimet e performancës së rezervuarëve të fushës dhe përfshijnë pritshmëritë rreth volumeve të vërtetuara dhe të pavërtetuara, të cilat janë të ponderuara me rrezikun duke përdorur projekte gjeologjike, ekonomike të prodhimit dhe rikuperimit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose NJGJP-je tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura për NJGJP-të shpërndahen për të pakësuar vlerën kontabël të aktiveve të tjera të njësisë (grupit të njësisë) në mënyrë proporcionale.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në vitet e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për tregues që humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të matur vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi

rimerret vetëm në masën që vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të kishte, neto nga harxhimi ose amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

(f) Detyrimi për nxjerrje nga përdorimi

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Dega ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që për shlyerjen e tij të ketë dalje të përfitimeve ekonomike. Provizionet maten duke skontuar flukset e pritshme në të ardhmen me një normë pa rrezik dhe përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasqyrës dhe rrezikun specifik të detyrimit. Provizionet nuk njihen për humbje operative të së ardhmes.

Aktiviteti i Degës sjell nevojën e kryerjes së aktiviteteve të çmontimit, nxjerrjes nga përdorimi dhe rehabilitimit të mjedisit kur tërheq nga përdorimi aktivitet afatgjatë materiale të tilla si pajisjet e puseve prodhuese. Provizioni llogaritet për koston e vlerësuar të restaurimit të terrenit dhe kapitalizohet në kategorinë e duhur të aktivitetit.

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(f) Detyrimi për nxjerrje nga përdorimi

Detyrimi për nxjerrje nga përdorimi matet me vlerën aktuale të vlerësimit më të mirë nga ana e drejtimit të shpenzimeve që kërkohen për mbylljen e detyrimit aktual në datën e raportimit. Pas matjes fillestare, detyrimi rregullohet në fund të çdo periudhe për të reflektuar kalimin e kohës dhe ndryshimet në flukset e ardhshme të vlerësuarat monetare që përbëjnë detyrimin.

Rritja e provizionit nga kalimi i kohës njihet si shpenzim financiar ndërsa rritjet/uljet për shkak të ndryshimeve në flukset e ardhshme të vlerësuarat monetare kapitalizohen. Këto kosto të kapitalizuara amortizohen nëpërmjet harxhimit dhe zhvlerësimit duke përdorur metodën e njërive të prodhimit. Kostot faktike për të përbushur detyrimin për nxjerrje nga përdorimi i ngarkohen provizionit deri në shumën e krijuar të provizionit.

(g) Qiratë

Dega zbaton SNRF 16 për qiratë. Në fillimin e një kontrate Dega vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira. Një kontratë është ose përmban një qira nëse ajo parashikon transferimin e të drejtës së përdorimit të një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe kundrejt pagesave. Kjo politikë zbatohet për kontratat që lidhen (ose janë ndryshuar) nga 1 janar 2019 e në vijim.

Sipas SNRF 16 “Qiratë” Dega i klasifikon kontratat e qirave të lidhura si qiramarrës në qira me vlerë të vogël, në qira afatshkurtëra dhe në qira. Shoqëria kontratat që përmbajnë një qira i kontabilizon elementët qira të kontratës si një qira veçmas nga ata elementë që nuk paraqesin një qira. SNRF 16 Qiratë lejon që një qiramarrës mund të zgjedhë të mos zbatojë kërkesat e standardit për: (a) qiratë me një afat 12 muaj ose më pak dhe që nuk përmban opsion blerjeje; dhe (b) qiratë për të cilin aktivi bazë është me vlerë të ulët.

Qiraja afatshkurtër përcaktohet si qira që nuk përmban një mundësi blerjeje dhe e cila në datën e fillimit, ka një afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak. Për tu konsideruar “afatshkurtër” qiraja duhet të ketë një afat maksimal të qirasë 12 muaj, pa ndonjë mundësi shtesë që mund të ushtrohet me diskrecionin e vetëm të shoqërisë. Për qiratë afatshkurtëra dhe ato me vlerë të vogël shoqëria i njeh pagesat e qirasë në shpenzimet e periudhës.

Për secilën kontratë të qirasë, dega si qiramarrëse fillimisht njeh një aktiv për të drejtën e përdorimit dhe një detyrim të qirasë. Në datën e fillimit të qirasë, aktivi i së drejtës të përdorimit matet me koston që përfshin shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë, çdo pagesë të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, minius çdo incetiv të qirasë, çdo kosto fillestare direkte të shkaktuar si dhe koston e vlerësuarat të rikthimit. Në datën e fillimit Dega mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në atë datë. Pagesat e qirasë duhet të skontoen duke përdorur një normë rritëse të huamarrjeje. Dega përdor normën e rritëse të huamarrjes si norma e skontimit që zbatohet për pagesat e qirasë.

Dega merr në konsideratë normën e huamarrjes në Shqipëri pasi kontratat e qirasë janë në Shqipëri. Norma rritëse e interesit të huamarrjes është norma e interesit që një qiramarrës do të duhet të paguajë për të marrë hua për një afat të ngjashëm, dhe me një siguri të ngjashme, fondet e nevojshme për të marrë një aktiv të një vlere të ngjashme me aktivin e së drejtës të përdorimit në një mjedis të ngjashëm ekonomik. Norma e skontimit e përdorur në datën e fillimit mbetet e pandryshuar gjatë periudhës së qirasë; përveç nëse një modifikim/rivlerësim i detyrimit të qirasë ndodh gjatë afatit të qirasë.

Dega përdor normën rritëse të interesit duke u bazuar në monedhën e huas (USD) dhe bankën në të cilën ka kryer transaksionet kryesore të huamarrjes, RZB banka. Ajo ka përdorur normën e interesit afersisht 5.3% për huamarrjen në dollarë Amerikan duke ju referuar normave të huamarrjes të overdraftit bankar me 1 janar 2020, për aktualizimin e detyrimeve të qirave që ka.

Dega mat të drejtën e përdorimit të aktivit (EDPA) duke përdorur modelin e koston, sepse ajo përdor modelin e koston për të gjitha aktivet e saj afatgjata. Sipas këtij modeli, EDPA është matur me kosto minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga zhvlerësimi; dhe e rregulluar për çdo rivlerësim të detyrimit të qirasë.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(h) Të ardhurat

Në Maj 2014, BSNK publikoi SNRF 15 "Të ardhura nga Kontratat me Klientët", për të zëvendësuar SNK 18 "Të Ardhurat", i cili përcakton parimet për raportimin e informacioneve të dobishme për përdoruesit e pasqyrave financiare për natyrën, shumën, kohën dhe pasigurinë e të ardhurave dhe mjeteve monetare që rrjedhin nga kontratat e njësisë ekonomike me klientët. Standardi është i zbatueshëm për Degën për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2018, i zbatueshëm në retrospektivë dhe zbatimi i hershëm është i lejuar. Adoptimi i SNRF 15 nuk ka një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Degës. Të ardhurat e Degës nga shitja e naftës së papërpunuar bazohen në shumën e specifikuar në kontratat me klientët.

Të ardhurat nga shitja e naftës së Degës regjistrohen kur kontrolli mbi produktin i transferohet blerësit, që ndodh zakonisht kur të drejtat ligjore i kalojnë klientit. Kjo ndodh përgjithësisht në kohën kur produkti transportohet (shitjet me eksport) ose dorëzohet në rafineri (shitjet brenda vendit) dhe mbledhja e të ardhurave është e sigurtë. Shuma e të ardhurave të njohura bazohet në shumën e specifikuar në kontratë.

(i) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare të Degës përfshijnë:

- të ardhura interesi;
- shpenzime interesi dhe komisione bankare;
- rritja nga skontimi i detyrimit për nxjerrje nga përdorimi;
- humbjen ose fitimin nga kurset e këmbimit për detyrimet dhe aktivet financiare, raportuar neto.

Të ardhurat ose shpenzimet e interesit njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(j) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Ai njihet në fitim ose humbje, përveçse kur lidhet me elementë që njihen drejtpërdrejt në fonde neto ose në të ardhura të tjera përmbledhëse. Interesat dhe gjokat që lidhen me tatimin mbi fitimin, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, trajtohen sipas *SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara*.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen e vitit dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm përfaqëson vlerësimin më të mirë të tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasiguritë që lidhen me tatimin mbi fitimin, nëse ka. Ai matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit. Aktivet tatimore aktuale dhe detyrimet kompensohen vetëm në qoftë se kriteret e caktuara përmbushen.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura, teprica kreditore tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme në masën që është e mundshme që përfitime të ardhshme tatimore do të sigurohen ndaj të cilave këto aktive do të përdoren.

Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportuese dhe pakësohen në momentin që nuk është më e pritshme që përfitimet e ardhshme tatimore do të realizohen; këto pakësime rimerren kur probabiliteti për përfitime të ardhshme tatimore përmirësohet. Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që ajo është e mundshme që përfitime të ardhshme tatimore do të sigurohen ndaj të cilave këto aktive do të përdoren. Fitime e ardhshme të tatueshme përcaktohen bazuar në planin e biznesit. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit. Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të pasojnë nga mënyra në të cilën Dega pret të rikuperojë ose të shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve të saj në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen vetëm nëse plotësohen disa kriteret.

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(j) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Disa shënime shpjeguese të Degës kërkojnë matjen e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare. Vlera e drejtë për qëllime të shënimeve shpjeguese është përcaktuar sipas metodave të mëposhtme. Për supozimet e bëra në lidhje me përcaktimin e vlerës së drejtë jepet më shumë informacion në shënimet përkatëse të aktivitetit apo detyrimit, atëherë kur është e zbatueshme.

Gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve, Dega përdor sa më shumë të jetë e mundur të dhënat e tregut. Vlera e drejtë kategorizohet në nivele të ndryshme të hierarkisë së vlerës së drejtë bazuar në të dhënat e përdorura në teknikat e vlerësimit si më poshtë:

Niveli 1: çmimi i kuotuar (i parregulluar) në tregje aktive për aktive dhe detyrime të njëjta. Niveli 2: të dhëna të tjera përveç çmimit të kuotuar në Nivelin 1, që janë të vrojtueshme për aktive dhe detyrime, qoftë drejtpërdrejtë (p.sh. çmimet) ashtu edhe jo drejtpërdrejtë (p.sh. derivat nga çmimet). Niveli 3: të dhëna për aktive dhe detyrime që nuk bazohen në të dhëna të vrojtueshme tregu. Nëse të dhënat që përdoren për të matur vlerën e drejtë të një aktiviteti ose detyrimi u përkasin niveleve të ndryshme të hierarkisë së vlerës së drejtë, atëherë matja e vlerës së drejtë kategorizohet në tërësinë e saj në të njëjtin nivel hierarkie të vlerës së drejtë si niveli më i ulët i të dhënave që janë të rëndësishme për matjen në tërësi.

(a) Mjete monetare dhe ekuivalentë, mjeete monetare të ngurtësuara, të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve, mjeteve monetare të ngurtësuara, të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, të pagueshmeve dhe detyrimeve të përlogaritura vlerësohet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme monetare të skontuara me normën e interesit të tregut në datën e raportimit. Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve, mjeteve monetare të ngurtësuara, të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, të pagueshmeve dhe detyrimeve të përlogaritura i përafrohet vlerës kontabël për shkak të maturitetit afatshkurtër.

(k) Standarde të reja ende jo efektive

Një numër standardesh të reja, ndryshime dhe interpretime të standardeve nuk janë ende të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Dega planifikon të zbatojë këto standarde kur të hyjnë në fuqi. Ndryshimet kryesore janë si vijon:

- Reforma e Normës së Interesit që Shërben si Standard Krahasues (Benchmark) e cila beri ndryshime:
 - Ndryshime të SNRF 9 Instrumentet Financiare
 - Ndryshimet në SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja
 - Ndryshime në SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënie e Informacioneve Shpjeguese
 - Ndryshime në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare

Një numër standardesh apo ndryshimesh të tjera të reja janë gjithashtu efektive nga 1 janar 2021 por nuk kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Degës. Për shkak të metodave të tranzicionit të zgjedhura nga Dega për të aplikuar këto standarde, informacioni krahasues në këto pasqyra financiare nuk është riparaqitur për të pasqyruar kërkesat e standardeve të reja. Aplikimi fillestar i standardeve nuk ka rezultuar në rregullime por është limituar në kërkesa për informacione shpjeguese shtesë

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Degës:

- KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin;
- Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9);
- Interesat Afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28);

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(k) Standarde të reja ende jo efektive (vazhdim)

8. Ndryshimet, Shkurtime ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19)
9. Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2017-2019 – Disa Standarde
10. Ndryshimet në referencat e Kornizës Konceptuale të Standardeve SNRF
11. Përkufizimi i një Biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)
12. Përkufizimi i materialitetit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)
13. Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28);
14. SNRF 17 Kontratat e sigurimit

Ndryshime të publikuara në prill 2021 në SNK 8 Politikat kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet; Ndryshime në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare; Ndryshimi në SNRF 16 Qiratë; Ndryshime në muajin maj 2021 të SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat. Te gjitha këto ndryshime kanë si datë efektive të hyrjes në fuqi periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2023 e më pas.

15. Koncesionet e Qirave të Lidhura me Covid-19 përtej 30 qershorit 2021, të publikuara në mars 2021, ndryshuan paragrafin 46B dhe shtuan paragrafët C20BA – C20BC. Një qiramarrës do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më 1 prill 2021 e më pas

8. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Aktivitetet e Degës ekspozohen ndaj shumë rreziqeve financiare që mund të vijnë si pasojë e kërkitimit, zhvillimit, prodhimit dhe aktiviteteve financiare të tilla si:

- (a) Rreziku i kredisë;
- (b) Rreziku i likuiditetit; dhe
- (c) Rreziku i tregut;

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Degës ndaj secilit prej rreziqeve më sipër, objektivave, politikave dhe proceseve të saj për matjen dhe administrimin. Përgjatë këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur shënime sasiore shtesë.

Bordi i Drejtorëve të shoqërisë mëmë të ndërmjetme mbikëqyr vendosjen dhe zbatimin nga drejtimi të strukturës së administrimit të rrezikut të Degës. Drejtimi ka zbatuar dhe monitoruar përputhshmërinë me politikën e administrimit të rrezikut. Politikën e administrimit të rrezikut të Degës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ajo përballet, për të vendosur kufizimet dhe kontrollin e duhur të rrezikut, dhe për të monitoruar rrezikun dhe përputhshmërinë me kushtet e tregut të aktiviteteve të saj.

(a) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare të Degës nëse një klient ose palë tjetër e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe lidhet kryesisht me të arkëtueshmet e Degës nga rafineritë e naftës ose autoritetet tatimore.

Vlera kontabël e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera të arkëtueshme përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Më 31 dhjetor 2021, Dega ka përdorur zbatimin e metodës së humbjes së pritur të kredisë (HPK) në vlerësimin e zhvlerësimit të arkëtueshmeve dhe nuk është kërkuar asnjë zhvlerësim i të arkëtueshmeve.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 vjetërsia e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera që nuk ishin zhvlerësuar ishte si më poshtë:

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

8. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

2021	Aktuale	30-60 ditë	61-90 ditë	Mbi 90 ditë	Totali
Rafineritë e naftës (shënimi 18)	1,192,567	-		17,266	1,209,832
TVSH (shënimi 18)	1,350,440	-		-	1,350,440
Totali	2,543,007	-		17,266	2,560,272
2020	Aktuale	30-60 ditë	61-90 ditë	Mbi 90 ditë	Totali
Rafineritë e naftës (shënimi 18)	21,619	-		19,574	41,193
TVSH (shënimi 18)	4,260,347	-		-	4,260,347
Totali	4,281,966	-		19,574	4,301,540

Dega konsideron me vonesë çdo shumë të arkëtueshme nga rafineritë e naftës me ditë vonesa më të mëdha se 60 ditë. Llogaritë e arkëtueshme përfshirë në tabelën më lart, me ose pa vonesë, nuk janë zhvlerësuar. Ato janë me palë të treta me të cilat Dega ka një histori arkëtimesh dhe i konsideron këto llogari si të mbledhshme. Të arkëtueshmet brenda vendit kanë afat pagese në fund të muajit që pason prodhimin dhe të arkëtueshmet nga eksportet arkëtohen brenda 30 ditëve nga data e dërgesës. Politika e Degës për të zbutur rrezikun e kredisë që lidhet me të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera është krijimi i marrëdhënieve të marketingut me një sërë klientësh.

Totali i të arkëtueshmeve prej rafinerive të naftës, përfshin shumën prej 1,210 milionë Lekë (2020: 41 milionë Lekë) me afat pagese 30 ditë, nga të cilat 1,210 milionë Lekë janë arkëtuar pas 31 dhjetorit 2021.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) i arkëtueshëm rimbursohet nga autoritetet tatimore pas kontrollit të tyre verifikues. Drejtimi pret të rikuperojë të gjithë shumën e mbetur të TVSH-së së arkëtueshme.

TVSH-ja e arkëtueshme prej 2,825 milionë Lekë përbëhet nga 791 milionë lekë, 375 milionë lekë, 85 milionë lekë, 349 milionë lekë, 567, milionë lekë vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2014, 2015, 2016 2017, 2018,dhe 913 milionë lekë të arkëtueshme përkatësisht per periudhen shtator – dhjetor 2020 dhe vitin 2021. Totali i TVSH-së së arkëtueshme përfshin një shumë prej 1,912 milionë Lekë (2020: 2,057 milionë Lekë) nën proces gjyqësor me autoritetet tatimore (shih Shënimin 25(b)).

Më 31 dhjetor 2021, Dega kishte të arkëtueshme nga autoritetet tatimore për TVSH të arkëtueshme vlerën prej 2,825 milionë Lekë (2020: 4,260 milionë Lekë) dhe shuma të parapaguara ndaj autoriteteve tatimore dhe doganore përkatësisht për parapagime të tatimit mbi fitimin dhe taksave të karbonit dhe të qarkullimit (K&Q) në një shumë totale prej 12,468 milionë Lekë (2020: 12,980 milionë Lekë).

Siç përmendet në shënimet 14 dhe 17, Dega është e përfshirë në mosmarrëveshje dhe rivlerësime të ndryshme me Qeverinë Shqiptare për çështje që, ndër të tjera, lidhen me deklarime tatimore, rikuperimin e kostove dhe taksave të K&Q. Ndërkohë që drejtimi beson se të gjitha shumat e arkëtueshme dhe të parapaguara janë të rikuperueshme në tërësinë e tyre, ekziston pasiguri në lidhje me arkëtueshmërinë përfundimtare dhe rikuperimin e këtyre shumave si dhe me kohën se kur ato do të paguhen. Korrigjimet për zgjidhje të mosmarrëveshjeve dhe vlerësimeve do të reflektohen në pasqyrat financiare kur ato të bëhen të ditura ose të pritshme apo kur pritshmëritë e drejtimit të ndryshojnë.

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Dega do të ndeshet me vështirësi në përmbushjen e obligimeve të lidhura me detyrimet e saj financiare që shlyhen me anë të transferimit të mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare. Përjasja e Degës për të administruar likuiditetin është që të sigurohet sa më shumë të jetë e mundur që do të ketë likuiditet të nevojshëm në përmbushjen e detyrimeve kur ato duhet të paguhen, si në situatë normale ashtu dhe në vështirësi, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e reputacionit të saj.

Zakonisht Dega sigurohet që do të ketë mjete monetare të mjaftueshme për të përmbushur shpenzimet operative të pritshme për një periudhë minimale prej 30 ditësh, përfshirë shërbimin e detyrimeve financiare; kjo përjashton ndikimin e rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, si për shembull katastrofat natyrore. Për të arritur këtë objektiv, Dega përgatit buxhete vjetore të shpenzimeve kapitale, të cilat monitorohen vazhdimisht dhe modifikohen kur konsiderohet e nevojshme.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

8. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Për më tepër, Dega përdor autorizime për shpenzime në projektet operative dhe jo operative për të administruar më tej shpenzimet kapitale. Për të lehtësuar programin e shpenzimeve kapitale, Dega ka mundësi financimi pa interes të siguruara nga Grupi (Shënimi 19). Dega gjithashtu tenton të përshtatë ciklin e pagesave me arkëtimet e të ardhurave nga nafta.

Afatet kontraktuale të detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

	Flukset kontraktuale monetare				
	Vlera Kontabël	Totali	Deri në 3 muaj	Më shumë se tre muaj	Pa-përcaktuar
31 dhjetor 2021					
Të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura	5,217,867	5,217,867	5,217,867	-	-
Të pagueshme ndaj palëve e lidhura	33,668,732	33,668,732	-	-	33,668,732
Huamarrje	35,873	35,873	-	35,873	-
Detyrime qiraje	194,144	194,144	44,533	149,611	-
	39,116,616	39,116,616	5,262,400	185,484	33,668,732
	Flukset kontraktuale monetare				
	Vlera Kontabël	Totali	Deri në 3 muaj	Më shumë se tre muaj	Pa-përcaktuar
31 dhjetor 2020					
Të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura	6,779,443	6,779,443	6,779,443	-	-
Te pagueshme ndaj paleve te lidhura	33,974,976	33,974,976	-	-	33,974,976
Huamarrje	624,018	624,018	480,503	143,515	-
Detyrime qiraje	152,888	152,888	-	152,888	-
	41,531,325	41,531,235	7,259,946	296,403	33,974,976

Detyrimet financiare ndaj palëve të lidhura në tabelat e mësipërme pasqyrojnë marrëveshjet aktuale kontraktuale ndërmjet Degës dhe Degës mëmë të ndërmjetme dhe këto flukse monetare mund të ndodhin shumë më herët, ose në një vlerë shumë të ndryshme nëse palët vendosin më pas të rishikojnë marrëveshjet kontraktuale për detyrimet e pagueshme.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

8. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuiditetit (Vazhdim)

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit, normat e interesit, çmimet e naftës, të ndikojnë të ardhurat e Degës ose vlerën e instrumenteve të saj financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të drejtojë dhe kontrollojë ekspozimin e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin.

(i) Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit është rreziku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme do të luhatet si rezultat i ndryshimeve në kurset e këmbimit. Ekspozimi i Degës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në shumat ekuivalente në Lekë në datën e raportimit është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021				
	USD	Lekë	Euro	Të tjera	Total
<i>(Në mijë Lekë)</i>					
Aktive financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	5,527,850	209,549	6,712	4	5,744,115
Shuma për çështje gjyqësore	-	13,296,013	-	-	13,296,013
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	171,668	-	-	-	171,668
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	1,192,566	1,367,705	-	-	2,560,271
Totali i aktiveve financiare	6,892,084	14,873,267	6,712	4	21,772,067
Detyrimet financiare					
Të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura	1,459,003	3,425,673	317,269	13,621	5,215,566
Hua	35,873	-	-	-	35,873
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	33,668,732	-	-	-	33,668,732
Totali i detyrimeve financiare	35,163,608	3,425,673	317,269	13,621	38,920,171
Pozicioni neto	(28,271,524)	11,447,594	(310,557)	(13,617)	(17,148,104)

(Në mijë Lekë)

	31 dhjetor 2020				
	USD	Lekë	Euro	Të tjera	Totali
Aktive financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	26,041	2,863	537	94	29,535
Mjete monetare të ngurtësuara					
Shuma për çështje gjyqësore	-	12,980,671	-	-	12,980,671
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	162,483	-	-	-	162,483
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	41,193	4,260,348	-	-	4,301,541
Totali i aktiveve financiare	229,717	17,243,882	537	94	17,474,230
Detyrime financiare					
Të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura	2,349,303	3,954,274	459,814	16,052	6,779,443
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	624,018	-	-	-	624,018
Hua	33,974,976	-	-	-	33,974,976
Totali i detyrimeve financiare	36,948,297	3,954,274	459,814	16,052	41,378,437
Pozicioni neto	(36,718,580)	13,289,608	(459,277)	(15,958)	(10,966,440)

Ekspozimi neto në USD përbëhet kryesisht nga shuma të pagueshme për palët e lidhura (Shënimi 19 (b)) të cilat janë të përcaktuara në USD dhe rreziku valutor prej tyre administrohet në nivel Grupi. Kurset e mëposhtme të këmbimit janë aplikuar:

	Kursi mesatar		Kursi në fund viti	
	2021	2020	2021	2020
Lekë/USD	103.52	108.65	106.54	100.84
Euro/USD	0.84	0.88	0.88	0.82
CAD/USD	1.25	1.34	1.27	1.27

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

8. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Analiza e ndjeshmërisë

Si rezultat i ekspozimit në lekë me autoritetet shqiptare (Shënimet 17 dhe 18), rezultati i Degës është më i ndjeshëm ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit Lek/USD. Në vitin 2021, forcimi i Lekut ndaj USD (2020: dobësimi i Lekut ndaj USD) rezultoi në një fitim neto nga kursi i këmbimit prej 979 milionë Lekë (2020: humbje neto nga kursi i këmbimit prej 802 milionë Lekë) (Shënimi 13). Një forcim (dobësim) i arsyeshëm i Euro dhe Lek ndaj USD më 31 dhjetor mund të ndikojë në matjen e instrumenteve financiarë që janë në monedhë të huaj si dhe fondet neto dhe fitimin ose humbjen me vlerat e paraqitura më poshtë:

	Fitim ose humbje	
	Forcim	Dobësim
31 dhjetor 2021: Euro (lëvizje 10%)	(31,650)	31,650
Lekë (lëvizje 10%)	1,144,759	(1,144,759)
31 dhjetor 2020: Euro (lëvizje 10%)	(54,325)	54,325
Lekë (lëvizje 10%)	271,625	(271,625)

(i) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që flukset monetare të ardhshme të luhaten nga ndryshimet e normës së interesit të tregut. Më 31 dhjetor 2021, Dega ka hua me interes dhe detyrime qiraje në një vlefte jo materiale dhe vlereson që nuk është e ekspozuar ndaj luhatjeve të normave të interesit.

(ii) Rreziku i çmimit të naftës

Rreziku i çmimit të naftës është rreziku që flukset e ardhshme dhe të ardhurat e Degës do të luhaten si rezultat i ndryshimeve në çmimin e naftës. Çmimet e naftës ndikohen jo vetëm nga marrëdhënia e Lekut Shqiptar me Dollarin Amerikan por gjithashtu nga ngjarjet ekonomike botërore që diktojnë nivelin e kërkesës dhe ofertës. Të ardhurat kryesore të Degës janë nga shitja e naftës së papërpunuar, me një çmim të bazuar në çmimin e naftës Brent, i ndryshuar sipas cilësisë. Më 31 dhjetor 2021, një ndryshim prej 1\$ për fuçi në çmimin e naftës së papërpunuar Brent, me të gjithë elementët e tjerë të mbajtur konstantë, do të ndikonte rezultatin neto pas tatimit për vitin me 135 milionë Lekë (2020: 152 milionë Lekë).

9. TË ARDHURAT NETO

Dega prodhon naftë të papërpunuar nga aktivet e saj në fushën e naftës Patos-Marinzë. Dega e shet prodhimin e saj bazuar në kontratat e shpërndarjes fizike me çmime fikse ose të ndryshueshme. Çmimi i transaksionit për kontratat me çmim të ndryshueshëm bazohet në çmimin bazë të naftës të përshtatur për cilësinë, vendndodhjen ose faktorët e tjerë, ku secili përbërës i formulës së çmimeve mund të jetë fiks ose i ndryshueshëm, në varësi të kushteve të kontratës. Sipas kontratave, dega kërkohet të dërgojë vëllime fikse ose të ndryshueshme të naftës së papërpunuar në palën kontraktuese.

Të ardhurat e prodhimit njihen kur Dega heq dorë nga kontrolli i sasisë së prodhuar në pikën e dorëzimit të rënë dakord sipas kushteve të kontratës. Shuma e të ardhurave të njohura të prodhimit bazohet në çmimin e transaksionit të rënë dakord dhe vëllimet e dorëzuara. Dega nuk ka ndonjë faktor që konsiderohet të jetë kufizues në njohjen e të ardhurave me faktorë të ndryshueshëm të çmimeve. Kontratat e Degës me klientët në përgjithësi kanë një afat prej një viti ose më pak, ku shpërndarja bëhet gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Të ardhurat e prodhimit zakonisht mblidhen 5 ditë pune pas lëshimit të faturës. Të ardhurat e mëposhtme njihen në një moment në kohë.

Në tabelën në vijim, të ardhurat nga kontratat me klientët janë të ndara sipas tregut gjeografik:

	2021	2020
Të ardhurat nga shitja e naftës bruto:		
Eksperte	19,485,676	13,290,660
Brenda vendit	3,030,362	1,639,672
	22,516,038	14,930,332
Pagesa për drejta minerare	(3,211,432)	(2,067,737)
Të ardhurat neto	19,304,606	12,862,595

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

9. TË ARDHURAT NETO (VAZHDIM)

Pagesat për të drejtat minerare perbehen si vijon:

Pagesa për drejta minerare	2021	2020
Pagesa të Prodhimit paraekzistues	1,002,638	534,286
Pjesa e qeverise në produkt dhe 10% e të drejtës minerale	2,208,793	1,533,452
Totali	3,211,431	2,067,738

10. SHPENZIME OPERATIVE

Tabela e mëposhtme detajon totalin e shpenzimeve operative

	2021	2020
Energji	1,436,636	1,448,302
Transport	344,221	469,567
Shpenzime trajtimi	571,045	652,491
Personeli dhe kosto të lidhura me të (shih shënimin 12)	723,022	755,518
Shërbime për pusët	509,904	664,127
Qira toke, leje dhe taksa lokale	806,141	745,651
Riparime dhe mirëmbajtje	424,619	469,173
Shërbime sigurie	322,016	307,651
Pajisje shpimi	183,151	131,834
Të tjera	291,517	106,757
Totali	5,612,272	5,751,071

11. SHPENZIMET E SHITJES DHE TRANSPORTIT

	2021	2020
Kosto e holluesve	501,232	406,440
Kostot e transportit	825,005	865,819
	1,326,236	1,272,259

12. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Tabela e mëposhtme detajon shumën totale të shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative:

	2021	2020
Personeli dhe kosto të lidhura me të (shih më poshtë)	473,627	616,429
Shpenzime ligjore, sigurim, taksa lokale	413,494	524,631
Strehim dhe shërbime utilitare	62,784	97,013
Komunikim dhe TI	93,734	71,776
Marrëdhënie me komunitetin dhe publikun	56,693	45,416
Riparim dhe mirëmbajtje	33,775	42,796
Të tjera	144,327	73,299
Totali	1,278,434	1,471,360

Pasqyra e Degës mbi fitimin ose humbjen dhe të ardhura të tjera përmbledhëse është përgatitur kryesisht mbi bazën e natyrës së shpenzimeve, me përjashtim të shpenzimeve të kompensimit të punonjësve, të cilat janë të përfshira në të dyja, në shpenzimet operative dhe shpenzimet e përgjithshme dhe administrative.

Tabela e mëposhtme detajon shumën totale të kompensimit të punonjësve duke përfshirë shpenzimet operative dhe shpenzimet e përgjithshme administrative:

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

12. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE (VAZHDIM)

	2021	2020
Pagat	936,266	1,102,993
Shpërblime	107,487	122,589
Kontributet shoqërore	81,008	75,572
Sigurimi i shëndetit dhe jetës	52,111	55,051
Të tjera	19,777	15,742
Totali	1,196,649	1,371,947

Te klasifikuara sipas funksionit ato paaqiten si në tabelën më poshtë:

	2021	2020
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative (shënimi 12)	473,627	616,429
Shpenzime operative (shënimi 10)	723,022	755,518
Total	1,196,649	1,371,947

Më 31 dhjetor 2021, Dega kishte 498 punonjës (2020: 497).

13. TË ARDHURA FINANCIARE NETO

	2021	2020
Të ardhura financiare		
Të ardhura neto nga kursi i këmbimit	-	793,392
	-	793,392
Shpenzime financiare		
Shpenzime interesi mbi huatë bankare	(7,255)	(27,797)
Rritja nga skontimi i detyrimit për nxjerrje nga përdorimi	(102,921)	(146,411)
Humbje neto nga kursi i këmbimit	(978,780)	-
Interest expense ROU	(9,495)	(8,291)
	(1,098,451)	(182,499)
Shpenzime financiare neto	(1,098,451)	610,893

14. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përbëhet si më poshtë:

	2021	2020
Emertimi		
Shpenzimi i tatimit aktual mbi fitimin	4,707,692	(1,391,352)
Tatim mbi fitimin duke përdorur normën tatimore në fuqi brenda vendit 50%	2,353,846	(695,676)
Diferenca të përhershme	(156,020)	(868,983)
Të tjera	(1,762)	(30,454)
Përfitimi i tatimit të shtyrë mbi fitimin	2,196,064	(1,595,113)

Bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure me Albpetrolin, tatimi mbi fitimin duhet të llogaritet sipas Ligjit Nr. 7811 datë 12 Prill 1994, i ndryshuar, “Mbi Miratimin me Ndryshime të Dekretit Nr. 782, datë 22.2.1994 – Mbi Sistemin Fiskal në Sektorin e Hidrokarbureve” dhe në përputhje me Licencën, sipas së cilës fitimi vjetor i tatueshëm llogaritet duke zbritur të gjitha shpenzimet operative dhe kapitale vjetore të ndodhura gjatë periudhës së zhvillimit dhe prodhimit nga të ardhurat totale vjetore me një normë tatimore të zbatueshme prej 50%. Në rast të një difference negative kur shpenzimet operative dhe kapitale vjetore janë më të larta se të ardhurat vjetore, diferenca konsiderohet si humbje tatimore për vitin dhe mbartet për t’u kompensuar me fitime të ardhshme të tatueshme. Humbjet tatimore mund të akumulohen dhe të barten deri në vitin kur ato kompensohen plotësisht. Humbjet e akumuluar tatimore përfaqësojnë kostot e zbritshme të akumuluar.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

14. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN (VAZHDIM)

Në përputhje me Marrëveshjen Hidrokarbure, shpenzimet e zbritshme të zhvillimit dhe prodhimit i raportohen mbi bazë tremujore AKBN-së në emër të Qeverisë Shqiptare. Shpenzimet e zbritshme duhet të vërtetohen nga AKBN dhe mund të jenë subjekt i kundërshtimeve me anë të kontrolleve që agjencia mund të kryejë brenda tre viteve nga data e raportimit.

Plani vjetor i Punës dhe Buxheti i paraqitet dhe aprovohet çdo vit nga AKBN dhe të gjitha kostot e përfshira në kostot e zbritshme të akumuluar janë subjekt i kontrolleve rutinë të vazhdueshme.

Më 27 korrik 2015 Dega ka marrë një raport kontrolli për shpenzimet e vitit 2011 nga AKBN, me kosto të kundërshtuara në vlerën 27,886 milionë Lekë (ekuivalenti i 247 milionë USD) që rezultoi në një pozicion të tatueshëm.

Kontrolle të tjera rutinë kanë pranuar pothuasje të gjitha kostot e Degës të përfshira në kostot e zbritshme të akumuluar dhe, bazuar në këto kontrolle dhe miratimin e planit nga AKBN,

Dega dhe shoqëria mëmë përfundimtare aktualisht po mbrojnë të gjitha kostot duke siguruar dokumentacionet e nevojshme justifikues.

Gjatë 2016, Dega firmosi një marrëveshje formale me AKBN dhe Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për të angazhuar një auditues ndërkombëtar si palë e tretë për të rishikuar e vlerësuar nëse kostot janë të certifikueshme si kosto hidrokarbure sipas Marrëveshjes Hidrokarbure dhe sipas Licencës.

Sipas këtij vlerësimi, gjatë vitit 2016 u përcaktua se Dega ka deklaruar saktë shpenzimet e vitit 2011 si kosto të rikuperueshme në përputhje me Marrëveshjen Hidrokarbure dhe Licencën.

AKBN apeloj vendimin e audituesit ndërkombëtar si palë të tretë në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit, i cila refuzoi atë në tërësi dhe ka deklaruar vendimin e audituesit ndërkombëtar si përfundimtar dhe detyrues (shih 25 (b). (i)).

AKBN ka kryer auditimet e vitit 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018 dhe ka nxjerrë gjetjet paraprake të cilat diskutohen më tej në shënimin 25 (b) (i).

Autoriteti tatimor shqiptar rillogarit detyrimet tatimore të Degës për vitin 2011 dhe do të përcaktojë një mekanizëm të përshtatshëm për të shlyer ose rimbursuar Degën për pagesat e bëra për organet tatimore. Ceshtja eshe ne gjykim.

Më poshtë paraqitet barazimi i tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën tatimore në fuqi me shpenzimin e tatimit mbi fitimin:

	2021	2020
Fitimi (humbja) para tatimit	4,707,692	(1,391,352)
Tatim mbi fitimin duke përdorur normën tatimore në fuqi brenda vendit 50%	2,353,846	(695,676)
Diferenca të përhershme	(156,020)	(868,983)
Të tjera	(1,762)	(30,454)
Përfitimi i tatimit mbi fitimin	2,196,064	(1,595,113)

Dega beson se llogaritja e provizionit të tatimit mbi fitimin është e përshtatshme pavarësisht pasigurive të mjedisit tatimor shqiptar dhe legjislacionit në fuqi si dhe beson që çdo kontroll i ardhshëm tatimor nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në pozicionin financiar të Degës, rezultatet e aktivitetit apo në flukset monetare. Megjithatë, për shkak të natyrës së ligjit mbi tatimin mbi fitimin, udhëzimeve dhe praktikave të lidhura me të, nuk është e mundur të ketë siguri që pozicioni aktual ligjor i tatimit mbi fitimin nuk do të kundërshtohet nga autoritetet tatimore.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

14. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN (VAZHDIM)

Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra lidhen me sa më poshtë:

	31 dhjetor 2021		
	Aktivet	Detyrimet	Neto
Aktive afatgjata materiale	-	(50,404,877)	(50,404,877)
Kosto të zbritshme të akumuluar	6,911,129		6,911,129
Pagesa bazuar në aksione	2,090,421		2,090,421
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi	2,753,246		2,753,246
Aktivi/(detyrimi) neto i tatimit të shtyrë	11,754,796	(50,404,877)	(38,650,081)

	31 dhjetor 2020		
	Aktivet	Detyrimet	Neto
Aktive afatgjata materiale	-	(49,588,561)	(49,588,561)
Kosto të zbritshme të akumuluar	10,584,584		10,584,584
Pagesa bazuar në aksione	1,993,808		1,993,808
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi	2,567,153		2,567,153
Aktivi/(detyrimi) neto i tatimit të shtyrë	15,145,545	(49,588,561)	(34,443,018)

Lëvizjet në diferencat e përkohshme gjatë vitit janë si më poshtë:

	Gjendja në çelje	Njohur në fitim ose humbje	Diferenca këmbimi	Gjendja në mbyllje
31 dhjetor 2021				
Aktive afatgjata materiale	(49,588,561)	1,930,343	(2,746,658)	(50,404,877)
Kosto të zbritshme të akumuluar	10,584,584	(4,150,598)	477,143	6,911,129
Pagesa bazuar në aksione	1,993,808	(15,631)	112,244	2,090,421
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi	2,567,152	39,823	146,271	2,753,246
Totali	(34,443,018)	(2,196,063)	(2,011,000)	(38,650,080)
31 dhjetor 2020				
Aktive afatgjata materiale	(55,303,492)	1,879,415	3,835,515	(49,588,561)
Kosto të zbritshme të akumuluar	11,932,706	(529,448)	(818,672)	10,584,584
Pagesa bazuar në aksione	2,164,435	(16,406)	(154,220)	1,993,808
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi	2,504,193	261,552	(198,592)	2,567,152
Totali	(38,702,158)	1,595,113	2,664,027	(34,443,018)

Detyrimi tatimor i shtyrë i Degës rezulton nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve. Tatimet e shtyra llogariten dhe maten në USD, duke qenë se edhe raportimi periodik i kostove të rikuperueshme të naftës ndaj AKBN është gjithashtu në USD.

15. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË

	2021	2020
Mjete monetare në bankë	5,741,594	27,896
Mjete monetare në arkë	2,519	1,639
	5,744,113	29,535

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

16. SHUMA DHE SHPENZIME TË PARAPAGUARA

	2021	2020
Parapagime për çështje gjyqësore - tatim i parapaguar mbi fitimin	4,867,627	5,390,534
Parapagime për çështje të tjera gjyqësore	1,600,357	1,600,768
Shpenzime të parapaguara	1,092,664	1,024,019
Paradhënie furnitorëve	118,748	102,383
Totali	7,679,396	8,117,704
Taksa e karbonit dhe qarkullimit	6,000,421	5,989,369
TVSH	1,474,060	-
Riklasifikim në Depozita afatgjata	-13,942,465	-12,980,457
Totali	1,211,412	1,126,616

Tatimi i parapaguar mbi fitimin prej 4,868 milionë Lekë (2020: 5,391 milionë Lekë) lidhet me shumën e paguara pas vlerësimit tatimor të marrë nga Dega prej 7,520 milionë Lekë (Shënim 14) në lidhje me kontrollin e AKBN për kostot e zbritshme të 2011. Siç përshkruhet në Shënimin 14 dhe 25(b)(i), në vijim të konkluzioneve të audituesit ndërkombëtar si palë e tretë, organet tatimore pruan shumën si të kthyeshme ndaj Degës dhe do të përcaktojnë një mekanizëm të përshtatshëm për të shlyer ose rimbursuar Degën për pagesat e bëra. Gjate vitit 2021 kjo shumë e parapaguar është zvogëlur me kompensimet e marra për pagesat e tatimit në burim, taksës së të drejtës minerare dhe tatimit mbi te ardhurat te punonjesve me një shumë prej 522,907 mijë lekë dhe nga rivlerësimet e tatimit fitimit me një shumë prej 398,116 mijë lekë.

Më 31 dhjetor 2021, taksat e parapaguara të K&Q prej 6,000 milionë Lekë (2020: 5,989 milionë) kanë të bëjnë me taksat e paguara të K&Q për importet e holluesve, për të cilat Dega pretendon të mos jetë subjekt dhe është në mosmarrëveshje me autoritetet doganore. Rikuperimi i këtyre shumave, varet nga rezultati i këtyre rasteve gjyqësore (Shënim 25(b)(ii)). Ndërkohë që drejtimi beson që këto shuma do të rikuperohen në tërësinë e tyre, koha e rikuperimit mbetet e pasigurtë, dhe prandaj vendosi që t'i riklasifikojë ato në afatgjata sipas vjetërsisë që nga koha kur janë paguar. Po ashtu Dega ka riklasifikuar si depozita afatgjata shumën prej 13,942 milion lekë.

17. TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

	2021	2020
Të arkëtueshme tregtare		
Alma Petroli Spa	959,084	-
Cepsa Trading SAU	29,740	18,126
Tosk Energy Sha	(270)	(255)
AL Global Sha	-	3,494
Albpetrol Sha	202,028	-
Të tjera	19,250	19,828
Totali të arkëtueshme tregtare	1,209,832	41,193
TVSH	1,350,440	4,260,348
Totali	2,560,272	4,301,541

Informacioni rreth ekspozimit të Degës ndaj rreziqeve të kredisë dhe të tregut dhe vlerësimi i zhvlerësimit për të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera përfshihet në Shënimin 8(a) dhe 8(c).

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

18. TË ARKËTUESHME DHE TË PAGUESHME ME PALËT E LIDHURA

(a) Të arkëtueshme nga palët e lidhura

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 të arkëtueshmet nga palët e lidhura rezultojnë si më poshtë:

	2021	2020
Sherwood International Petroleum Ltd.	151,107	143,023
Charter Power Invest Ltd	20,561	19,460
	171,668	162,483

(b) Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Më 31 dhjetor 2021, shuma e pagueshme ndaj palëve të lidhura prej 33,669 milionë Lekë (2020: 33,975 milionë Lekë) përfaqëson financimin pa interes të marrë nga shoqëritë mëmë të ndërmjetme dhe përfundimtare ("Palët Financuese") për kapital qarkullues dhe qëllime investimi. Kjo shumë përfshin ngarkimin e disa kostove të kryera nga shoqëria mëmë e ndërmjetme për llogari të Degës. Shuma gjendje është e pagueshme nga Dega me lëshimin e një urdhri pagese nga Palët Financuese, i cili do të përmbajë kushtet dhe formën e pagesës. Në çdo rast, Dega ka të drejtën e pagesës më të hershme, në një ose disa kështu, para lëshimit të urdhrit përkatës të pagesës nga Palët Financuese.

19. INVENTARË

	2021	2020
Nafta bruto	727,029	550,935
Karburant dhe të tjera	42,026	25,266
Totali	769,055	576,201

20. KTIVET AFATGJATA MATERIALE

	Aktive nafte	Pajisje, mobilje dhe instalime	Totali
<i>Kosto</i>			
Më 1 janar 2020	199,458,639	2,022,203	201,480,842
EDPA sipas SNRF 16	-	(73,556)	(73,556)
Shtesa	2,682,569	2,390	2,684,959
Diferenca këmbimi	(14,513,188)	(140,051)	(14,653,239)
Më 31 dhjetor 2020	187,628,020	1,810,986	189,439,006
EDPA sipas SNRF 16	-	92,029	92,029
Shtesa	1,340,170	5,590	1,345,760
Diferenca këmbimi	10,644,811	87,725	10,732,536
Më 31 dhjetor 2021	199,613,001	1,996,330	201,609,331
<i>Harxhimi dhe amortizimi i akumuluar</i>			
Më 1 janar 2020	(89,466,650)	(1,407,209)	(90,873,859)
Shpenzimi i vitit	(6,257,264)	(112,887)	(6,370,151)
Diferenca këmbimi	6,873,206	108,921	6,982,127
Më 31 dhjetor 2020	(88,850,708)	(1,411,175)	(90,261,883)
Shpenzimi i vitit	(5,191,217)	(90,373)	(5,281,590)
Diferenca këmbimi	(5,173,750)	(82,383)	(5,256,134)
Më 31 dhjetor 2021	(99,215,675)	(1,583,902)	(100,799,577)
<i>Vlera e mbartur</i>			
Më 1 janar 2020	109,991,989	614,994	110,606,983
Më 31 dhjetor 2020	98,777,312	399,811	99,177,123
Më 31 dhjetor 2021	100,397,326	412,428	100,809,754

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

20. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021, kostot e ardhshme të vlerësuara të zhvillimit që lidhen me rezervat e vërtetuara dhe të mundshme prej 114,727 milionë Lekë (2020: 94,386 milionë Lekë) janë përfshirë në bazën e llogaritjes së shpenzimit të harxhimit.

Dega ka kapitalizuar shpenzime të përgjithshme administrative për shumën totale 203 milionë Lekë gjatë vitit të mbyllur 31 dhjetor 2021 (2020: 260 milionë Lekë) dhe që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e zhvillimit dhe prodhimit.

(a) Garanci

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 të gjitha aktivet e Degës, deri në kufirin e shumës më të lartë mes ekuivalentit në Lekë të 95 milion USD ose vlerës kontabël, ishin vendosur si garanci për huamarrjen nga Grupi, te cilat janë çliruar mbas dates 31 dhjetor 2021.

(b) Test zhvlerësimi

Si pasojë e luhatjeve në çmimet e pritshme të naftës, drejtimi testoi për zhvlerësim aktivet e naftës më 31 dhjetor 2020. Për qëllime të testimit për zhvlerësim, aktivet e naftës u grupuan në një NJGJP që është fusha naftë-mbajtëse e Patos-Marinzës (shënimet 4(a) dhe 7(e)(ii)).

Shuma e rikuperueshme e NJGJP-së është vlerësuar bazuar në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme që do të rrjedhin nga NJGJP-ja (vlera në përdorim). Vlera në përdorim është bazuar në vlerën neto aktuale të rezervave të vërtetuara dhe të mundshme të cilat janë vlerësuar nga inxhinierët e pavarur të rezervuarëve, duke marrë në konsideratë shpenzimet e ardhshme të zhvillimit të vlerësuara që janë të nevojshme për të sjellë ato rezerva në shfrytëzim.

Vlera në përdorim e llogaritur e NJGJP-së ishte 26,315 milionë Lekë më e lartë se vlera e saj kontabël neto dhe si rezultat nuk u njoh ndonjë zhvlerësim.

Supozimet kyçe të përdorura në vlerësimin e shumës së rikuperueshme janë subjekt i vlerësimeve të drejtimit (shënimi 4(a)) dhe kanë të bëjnë me vlerësimin e rezervave, çmimet e ardhshme të naftës dhe normën e skontimit:

- Rezervat - rezervat totale të vërtetuara dhe të mundshme të naftës së papërpunuar më 31 dhjetor 2021 të vlerësuara në 2021 nga inxhinierët të pavarur të rezervuarëve si të rikuperueshme gjatë periudhës së vlerësuar të licencës
- Çmimet e naftës - parashikimi i çmimit të naftës së papërpunuar u bazua në parashikimet e jashtme të çmimit Brent, korrigjuar me një faktor 0.79 për përpunimin, kostot e transportit dhe ndryshimin në cilësi. Çmimi i naftës së papërpunuar parashikuar për vitin 2021 ishte 63 USD/fuçi duke u rritur më pas në 85 USD/fuçi në fund të vitit;
- Norma e skontimit - flukset monetare të ardhshme janë skontuar duke përdorur një normë skontimi para tatimit prej 15%, llogaritur mbi bazën e kostos mesatare të ponderuar të kapitalit të Grupit dhe të rregulluar për rreziqet specifike të vendit.

Më 31 dhjetor 2021, drejtimi bëri një rishikim të nevojës për zhvlerësimin të aktiveve të naftës dhe vlerësoi se nuk kishte tregues për zhvlerësimin e tyre.

(c) Kufizimi për titullin e aktiveve

Sipas Licencës, titulli i pronësisë mbi aktivet që përfaqësojnë kostot e zhvillimit dhe prodhimit dhe të emërtuara si aktive të naftës, të cilat janë në zotërim të Degës në lidhje me operacionet e naftës, do të transferohen tek AKBN në momentin më të hershëm midis kohës që kostot e këtyre aktiveve janë rikuperuar plotësisht dhe kohës së përfundimit dhe dorëzimit të operacioneve hidrokarbure. Bazuar në kushtet e Licencës, Dega mban të drejtën për përdorimin e plotë dhe të lirë të këtyre aktiveve gjatë afatit të Marrëveshjeve.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, kostot e aktiveve të naftës plotësisht të rikuperuara për qëllimet e mësipërme janë subjekt i auditimit dhe vërtetimit përfundimtar nga AKBN të kostove të rikuperueshme të naftës të raportuara nga Dega për vitet 2012-2019 (Shënimi 24(b)(i)).

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

20. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

(d) Edrejta e përdorimit të AAM

Në këtë zë të pasqyrës së pozicionit financiar paraqiten kontratat me qira që ka patur dega të lidhura para vitit 2021. Në përputhje me kërkesat e SNRF 16 ajo i paraqet këto kontrata si aktive, e drejta e përdorimit të aktiveve me qira. Njohja dhe vlerësimi është bërë në përputhje me kërkesat e SNRF 16 (Shenimi 7).

Shoqëria ka paraqitur te drejten e përdorimit të aktiveve (EDP) me qira, me vlerën kotnabel neto minus amortizimin më 1 janar 2019. Pra ka njohur EDP në retrospektivë dhe e ka korrigjuar atë me amortizimin kumulativ dhe efektin e ka paraqitur në fitimet e pashpërndara. Po ashtu ka paraqitur edhe detyrimin e qirase me vlerën e mbetur të shumës së aktualizuar minus shumën e pagesave të bera para datës 1 janar 2019 të detyrimeve të qirasë (Shenimi 7).

Aktualizimi është bërë me normën e interesit efektiv 5.3% që është norma e interesit të huamarjes më overdraft në USD. Duke qënë se kontratat kanë të njëjtën afat skadence është përdorur e njëjta normë interesi.

Një paraqitje e dinamikës së këtyre aktiveve paraqitet si në vijim:

Pasqyra e levizjese të së drejtës së përdorimit të Aktiveve 000/lekë

	Gjendja më 01.01.2021	Shtesa	Pakesime	Gjendja më 31.12.2021
EDP Aktive me Qira	152,888	92,029	-	244,917
Qira të perfunduara	-	-	(17,473)	(17,473)
Am.Akumuluar EDP Aktiveve me qira	-	-	(32,505)	(32,505)
VKN 31.12.2020	152,888	92,029	(49,978)	194,939

21. HUATË AFATSHKURTRA

Më 31 dhjetor 2021 Shoqëria, në 15 prill 2021, ka shlyer huane afatshkurter me bankën Raiffeisen (dhjetor 2020 – 484 million).

Shoqëria hyri në një hua bankare në maj 2020 me një normë interesi vjetore prej 2.62%, e cila maturohet më 10 shkurt 2022. Qeveria Shqiptare prezantoi një skemë të përgjithshme të mbështetjes financiare në përgjigje të ndikimit ekonomik që pati pandemia COVID -19, i cili siguroi një garanci për shumën e plotë të kredisë së re të korporatës të kualifikuar të lëshuar nga bankat në Shqipëri. Kredia u përcaktua të përdoret për pagat dhe pjesën së punëdhënësit të taksës së sigurimeve shoqërore për muajt prill deri në qershor 2020. Vlera e huase në 31 dhjetor 2021 është 36 mijë Leke (31 dhjetor 2020 – 141 million),

22. TË PAGUESHME DHE DETYRIME TË PËRLLOGARITURA

	2021	2020
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	2,428,763	5,547,544
Detyrime të përllogaritura	2,789,104	1,231,899
Totali	5,217,867	6,779,443

23. DETYRIM PËR NXJERRJE NGA PËRDORIMI

	2021	2020
Gjendje më 1 janar	5,134,303	5,008,387
Shtesa	(23,954)	(74,077)
Ndryshimi i normës së skontimit	-	423,693
Diferenca të kursit të këmbimit	290,217	(359,587)
Rritja nga skontimi i detyrimit për nxjerrje nga përdorimi	105,925	135,887
Gjendje më 31 dhjetor	5,506,492	5,134,303

23. DETYRIM PER NXJERRJE NGA PERDORIMI (VAZHDIM)

Detyrimi për nxjerrje nga përdorimi i Degës rezulton nga interesat e saj pronësore mbi aktive naftë që përfshijnë pusët dhe sistemet e mbledhjes. Detyrimi total për nxjerrje nga përdorimi është vlerësuar bazuar në interesat pronësore neto mbi gjithë pusët dhe pajisjet, kostot e vlerësuara për restaurimin dhe braktisjen e këtyre puseve dhe pajisjeve dhe kohën e vlerësuar të ndodhjes së kostove në vitet e ardhshme. Kostot e vlerësuara të nxjerrjes nga përdorimi bazohen në vlerësime të brendshme duke përdorur përvojën e Grupit me transaksione të ngjashme nxjerrjeje nga përdorimi dhe rishikohen rregullisht.

Dega ka vlerësuar që shuma totale e pa skontuar e nevojshme për të shlyer detyrimin për nxjerrje nga përdorimi më 31 dhjetor 2021 është 7,536 milionë Lekë (2020: 7,311 milionë Lekë).

Ky detyrim do të shlyhet në fund të licencës 25 vjeçare të Degës për Marrëveshjen e Patos-Marinzës, nga e cila kanë mbetur dhe 9 vite. Më 31 dhjetor 2021, detyrimi është skontuar duke përdorur një normë interesi pa rrezik 4% (2020: 4%) dhe një normë inflacioni prej 2% (2020: 2.0%).

24. ANGAZHIMET DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA

(a) Detyrimet e kushtëzuara

Mosmarrëveshjet me AKBN dhe Autoritetet Tatimore

Dega ka patur mosmarrëveshje me Autoritetet tatimore Shqiptare në lidhje me shumën e kostove të rikuperueshme dhe me tatimin mbi fitimin. Dega ka ndjekur procedurat për të apeluar rezultatet e kontrollit të kryer nga AKBN duke ndjekur hapat procedurale që përcaktohen në Marrëveshjen Hidrokarbure. Ligji shqiptar mbi “Procedurat Tatimore” nuk ka asnjë dispozitë që të rregullojë kontrollin e kryera nga AKBN, ndërsa fitimi i tatueshëm i Degës rregullohet nga ligji fiskal mbi aktivitetet hidrokarbure. AKBN ka autoritetin për të certifikuar njohjen e kostove për qëllime të fitimit të tatueshëm.

Në vijim të rezultateve të arbitrazhit të ndjekur nga dega në vitet paraardhëse kundrejt pretendimeve të AKBN dhe të autoriteteve tatimore, dega si rezultat i fitimit të këtij arbitrazhi, ka të drejtë për rimbursim për shumën prej 5,391 milion Lekësh të tatimit mbi fitimin, i cili është njohur dhe paraqitur edhe në llogarinë e-tax të Bankers pranë autoriteteve tatimore, që dëshmon njohjen nga autoritetet tatimore e këtij detyrimi ndaj Bankers. Nuk është e mundur të vlerësohet koha e rimbursimit dhe pagimi i këtij tatimi mbi fitimin për shkak të vështirësive të likuiditetit të autoriteteve tatimore.

Dega ka paguar taksa K&Q mbi gazoilin dhe karburantin e importuar gjatë periudhës nga maji 2012 deri në janar 2014 dhe ka kërkuar rimbursimin e këtyre taksave të paguara në import dhe më pas ka pretenduar rimbursimin e shumës afërsisht 2,497 milionë Lekë nga Gjykata Administrative e Durrësit. Gjykata Administrative refuzoi pretendimin e Degës dhe më pas kjo e fundit e ka apeluar më tej çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në korrik 2017, Gjykata Administrative e Apelit vendosi në favor të Degës, duke mbështetur arsyetimin që Dega është e përjashtuar nga taksat e K&Q. Autoritetet tatimore kanë paraqitur një rekurs për çështjen në Gjykatën e Lartë ku aktualisht çështja është në shqyrtim. Dega ka marrë një vendim të favorshëm mbi një çështje të ngjashme gjyqësore edhe në të shkuarën, si rezultat i të cilit, në vitin 2015, Dega rikuperoi rreth 1,175 milion Lekë taksa K&Q paguar për vitin 2011.

Bankers ka paguar tatimin e K&Q për gazoilin dhe karburantin e importuar në shumën prej 5,825 milion lekë për periudhën shkurt 2014 - dhjetor 2020 duke kërkuar rimbursimet përkatëse në lidhje me periudhat specifike (Shkurt 2014 - qershor 2014, korrik 2014 - dhjetor 2014, janar 2015 - Maj 2015; Qershor 2015 - Dhjetor 2015; Janar 2016 - Dhjetor 2017, Janar 2018 -Dhjetor 2019). Kërkesa për rimbursim janë në shqyrtim ose të përfunduara në Gjykatat Administrative të Shkallëve të Para Durrës dhe Vlorë dhe në pergjithësi janë trajtuar në favor të Degës.

Shuma totale prej 6,000 milionë Lekë e taksave të parapaguara për K&Q (2020: 5,989 milionë Lekë) është përfshirë në shumat e parapaguara afatgjata dhe drejtimi i Degës pret ta mbledhë këtë shumë.

Bazuar tek këshilltari i jashtëm ligjor që përfaqëson Degën në procesin gjyqësor dhe tek vendimet e favorshme gjyqësore në të kaluarën, drejtimi beson përfundimi i çështjeve gjyqësore do të rezultojë në rimbursimin e taksave të parapaguara të K&Q. Përjashtimi nga detyrimet e importit është dhënë nga kuadri ligjor tatimor mbi operacionet hidrokarbure të cilit Dega i nënshtrohet dhe, sipas përkufizimeve të Kodit Doganor, taksat e K&Q do të konsideroheshin si detyrime të importit.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

24. ANGAZHIMET DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA (VAZHDIM)

Mosmarrëveshjet me AKBN dhe Autoritetet Tatimore (vazhdim)

Shoqëria ka kërkuar rregullisht rimbursimin e TVSH-se dhe për rrjedhojë ka qenë subjekt i kontrolleve tatimore të vazhdueshme çdo vit. Nga kontrollet e kryera nga inspektorët tatimore për Tatimpaguesit e Medhenj, janë vlerësuar detyrime të ndryshme për TVSH-ne, tatimin në burim dhe renten minerare. Keto rivlersime janë apeluar, dhe Shoqëria është në pritje të seancave degjimore të radhës.

Ndërkohë që drejtimi beson se taksat e paguara të K&Q dhe TVSHpërfshirë dhe ato që nuk janë kontestuar ende, do të rikuperohen në tërësinë e tyre, koha rikuperimit të tyre mbetet e pasigurtë, dhe prandaj vendosi që t'i riklasifikojë ato në afatgjatë sipas vjetërsisë që nga koha kur janë paguar (referoju gjithashtu Shënimin 17).

Çështje gjyqësore të tjera

Dega është subjekt i pretendimeve dhe çështjeve të tjera gjyqësore që vijnë nga veprimtaria e zakonshme e biznesit. Drejtimi beson që çdo pretendim i mundshëm në të ardhmen nuk do të ketë ndonjë ndikim negativ material në pozicionin financiar të Degës, rezultatet e operacioneve ose flukseve monetare.

25. PALËT E LIDHURA

Dega ka marrëdhënie si palë e lidhur me shoqëritë mëmë përfundimtare dhe të ndërmjetme, shoqëri të tjera brenda Grupit dhe stafin kryesor drejtues. Një përmbledhje e balancave dhe transaksioneve me palët e lidhura paraqitet si më poshtë:

	2020	2020
Të arkëtueshme		
Të arkëtueshme të tjera nga SIPL (shënimin 18(a))	151,107	143,023
Të arkëtueshme tregtare nga Charter Power	20,561	19,460
	171,668	162,483
Detyrime		
Të pagueshme ndaj shoqërive mëmë përfundimtare dhe të ndërmjetme (shënimin 19(b))	33,668,732	33,974,976
	33,668,732	33,974,976
Shitja e mallrave		
Shitja e materialeve	78,160	74,586
	78,160	74,586
Kompensimi i drejtuesve kryesor		
Paga	192,650	174,862
Shpërblime afatshkurtra	46,435	60,534
Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës	76,087	198,521
	315,172	433,917

26. DETYRIME QIRAJE

Shoqëria merr me qira ndërtesa zyre, oborr depozitimi, magazina dhe apartamente. Me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve bazë me vlerë të ulët, secila qira pasqyrohet në bilanc si një aktiv i së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje. Qiratë nuk mund të anulohen dhe pagesat janë fikse. Shoqëria i klasifikon aktivet e saj të së drejtës së përdorimit në mënyrë të qëndrueshme ndaj AAM (shiko shënimin 21). Qiratë janë të kufizuara në një afat qiraje prej 5 vjetësh.

Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

26. DETYRIME QIRAJE (VAZHDIM)

Detyrime Qiraje	
Gjendja në 1 janar 2021 (IFRS 16)	152,888
Qira të përfunduara	(17,473)
Shtesa qiraje	92,029
Pagesat e qirase	(43,318)
Diferenca kembimi	10,018
Gjendja në 31 dhjetor 2021	194,144
Pjesa afatshkurter e qirase	44,533
Detyrime qiraje	149,611

27. NGJARJET PAS DATES SE EPFUNDIMITI TE PERIDUHES RAPORTUESE

Çmimi i naftës së papërpunuar është determinanti kryesor i performancës operative të Degës dhe flukseve të parasë. Çmimi i naftës së papërpunuar ka një histori luhatshmërie, sepse, ashtu si mallrat e tjera, ndikohet nga ulje-ngritjet në ciklin ekonomik dhe disa variabla makro të tjerë që janë jashtë kontrollit të drejtimit. Gjysma e parë e vitit 2022 shfaqti tendencë në rritje në çmimet e naftës dhe produkteve të tjera të energjisë që lidhen me nderhyrjen ushtarake të Rusisë ndaj Ukrainës. Çmimi Brent ka reflektuar tendencat aktuale dhe do të përmirësojë pozitivisht projeksionin e planifikuar për të ardhurat dhe flukset monetare të Degës. Drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje tjetër vijuese që do të kërkonte rregullime ose dhënie informacionesh shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.